EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5696
E enjte, 7 shkurt 2019
çmimi 0.40 €

Maqedonia e Veriut nënshkruan Protokollin për anëtarësim në NATO

FAQE 2

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR 'EPOKËN E RE', NASER RUGOVA

FAQE 4-5

LDK-ja s'bëhet pjesë e këtij dialogu pa legjitimitet politik dhe elektoral

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Naser Rugova, ka thënë se miratimi i Ligjit për dialog i bën paralelizëm Kushtetutës dhe institucioneve shtetërore. Ai ka thënë se procesin e dialogut me Serbinë duhet ta udhëheqin krerët e institucioneve shtetërore që kanë përgjegjësi kushtetuese e jo bashkëkryesuesit e niveleve të tjera. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Rugova ka deklaruar se LDK-ja nuk do të bëhet pjesë e këtij dialogu pa legjitimitet politik dhe elektoral. Ai ka thënë se Qeveria dhe partnerët e koalicionit e kanë futur vendin në krizë politike si dhe e kanë vënë në pikëpyetje miqësinë me partnerët tanë strategjikë. Prandaj, sipas Rugovës, zgjidhja e vetme janë zgjedhjet e reja

SYLEJMAN SELIMI ËSHTË INTERVISTUAR NGA PROKURORIA SPECIALE NË PRISHTINË

Gashi: Sylejman Selimi është intervistuar nga Specialja si i dyshuar

Për rreth dy orë ish-komandanti i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Sylejman Selimi, është intervistuar të mërkurën në Prishtinë nga Gjykata Speciale. Avokati i tij, Tomë Gashi, në një konferencë për media ka konfirmuar se klienti i tij është intervistuar në cilësinë e të dyshuarit. Megjithatë, Gashi nuk ka treguar se për çfarë është i dyshuar Sylejman Selimi FAQE 3

Dënohet abuzimi i 16-vjeçares nga Drenasi

FAQE 7

AKTUALE

ME ALI AHMETIN MAQEDONIA NË NATO F. 12

Shkruan: Ismet SYLEJMANI

'TREPÇA' DHE STUDENTËT, SFIDAT POLITIKE DHE SHOQËRORE NDËR VITE DHE PERSPEKTIVA PËR TË ARDHMEN F. 11

Shkruan: Ferat SHALA

AUTOSTRADA E DUKAGJINIT PËRFUNDON BRENDA KATËR VJETËVE F. 6

PSD-JA KËRKON TË RRITET PAGA MINIMALE F. 5

EKONOMI

NËNSHKRUHET KONTRATA PËR INVESTIMET NË HEKURUDHË F. 9

BLERJA PA TENDER E MALLRAVE DHE SHËRBIMEVE CENON BARAZINË E SEKTORËVE F. 9

RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë-Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Maqedonia e Veriut nënshkruan Protokollin për anëtarësim në NATO

Në Bruksel është nënshkruar të mërkurën protokolli për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në NATO, në përputhje me marrëveshjen me Greqinë për zgjidhjen e kontestit 27-vjeçar të emrit. Në ceremoninë e nënshkrimit ka marrë pjesë ministri i Punëve të Jashtme i Maqedonisë, Nikolla Dimitrov, dhe 29 ambasadorët e shteteve anëtare të Aleancës, të cilët kanë vendosur firmat në protokollin për anëtarësimin e Maqedonisë me emrin e ri, Republika e Maqedonisë së Veriut

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 SHKURT - NATO-ja e ka nënshkruar të mërkurën Protokollin me Republikën e Maqedonisë së Veriut për anëtarësimin e kësaj të fundit në Aleancë, si vendi i tridhjetë. Njëzetë e nëntë (29) ambasadorë dhe përfaqësues të vendeve anëtare të NATO-s e nënshkruan Protokollin, i cili u lejon zyrtarëve të Shkupit të marrin pjesë në çdo seancë dhe organizim të Aleancës Veriatlantike në Bruksel, por ende pa të drejtë vote.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, gjatë ceremonisë ka thënë se anëtarësimi i Maqedonisë së Veriut në NATO do të sjellë më shumë qëndrueshmëri dhe siguri në rajon. "Ju kemi pritur një kohë të gjatë që të na bashkoheni në familjen tonë. Me nënshkrimin e protokollit fillon procesi i ratifikimit i cili pres që të kalojë lehtë. Nga sot, përfaqësuesit tuaj do të na bashkohen në këtë tavolinë. Bashkërisht do të sjellim vendime", ka deklaruar Stoltenberg. Ai e ka vlerësuar aktin si një ditë historike dhe të posaçme për Maqedoninë, por edhe për NATO-n dhe rajonin në përgjithësi.

Anëtarësimi i plotë në NATO do të ndodhë pas ratifikimit të dokumentit për anëtarësim nga të gjitha parlamentet e shteteve anëtare të NATO-s. Në fazën e tanishme, Maqedonia do të mund të marrë pjesë në të gjitha formatet kyçe të Këshillit Euroatlantik, gjegjësisht do të jetë pjesë e sistemit dhe procedurave të NATO-s dhe do të marrë pjesë në trupat e Aleancës, por pa të drejtën e votës. "Maqedonia së shpejti do të jetë Maqedonia e Veriut. Kjo është çështje ditësh. Kemi dëshmuar se mund t'i zgjidhim problemet me të cilat përballemi. Ishte një rrugë e gjatë. Përmbushëm atë për të cilën ishin angazhuar anëtarët e parë të Parlamentit tonë. Ky akt sot është rezultat i punës dhe përpjekjeve të shumë gjeneratave dhe përgjegjësi e gjeneratës sonë", ka deklaruar ministri i Punëve të Jashtme, Nikolla Dimitrov.

Para anëtarësimit të plotë, secili vend anëtar i NATO-s duhet ta ratifikojë protokollin. Greqia pritet të jetë vendi i parë që do t'i japë dritën jeshile fqinjit të saj për anëtarësim në Aleancën e NATO-s, pasi kishte bllokuar rrugët e integrimit të Maqedonisë për gati tre dekada për shkak të problemit të emrit Maqedoni, meqë një rajon në Greqinë veriore e mban të njëjtin emër dhe për shkak të pretendimeve të mundshme të Shkupit ndaj territorit dhe historisë greke. Parlamenti grek pritet ta ratifikojë protokollin të premten.

Pas kësaj, Marrëveshja e Prespës e arritur më 17 qershor 2017, përkatësisht emri Republika e Maqedonisë së Veriut, hyn në fuqi dhe në përdorim zyrtar.

Shkupi do ta njoftojë Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe organizatat e tjera ndërkombëtare për emrin e ri dhe t'u kërkojë atyre që ta përdorin atë.

Në Qeverinë e Maqedonisë nënshkrimin e protokollit për anëtarësim në NATO është vlerësuar si një nga ngjarjet më të rëndësishme që nga pavarësia e vendit në vitin 1991. Ky akt dhe anëtarësimi i plotë që pason, sipas Qeverisë, realizon synimin kryesor të qytetarëve të Maqedonisë, për të qenë pjesë e familjes euroatlantike në të cilën garantohet siguri, prosperitet dhe zhvillim ekonomik. "Kjo është një ditë historike për të gjithë qytetarët tanë. Sot Aleanca më e madhe e sigurisë në botë, NATO, na uroi mirëseardhje. Sot ne u ulëm krah për krah me aleatët tanë, në të njëjtën tryezë, në të njëjtën Aleancë. Jemi të lumtur dhe duhet të jemi, sepse ne kemi siguruar stabilitet të qëndrueshëm për vendin tonë, siguri dhe paqe. Progresi dhe zhvillimi tani janë të pandalshëm. Brezat tanë dhe fëmijët e gjeneratave tona do të jetojnë më mirë në vend dhe në rajon që rrezaton shpresë", ka shkruar në llogarinë e vet në "Facebook", kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev.

Ahmeti: Nënshkrimi i protokollit për anëtarësimin e Maqedonisë në NATO, ditë e jashtëzakonshme

Lideri i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, e ka quajtur vendim të jashtëzakonshëm nënshkrimin e protokollit për anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë Veriore në NATO. Ai ka thënë se ky vendim është i veçantë për qytetarët e këtij shteti, rajonin dhe komunitetin amerikan dhe evropian. "E jashtëzakonshme! Dita e sotme është shumë e veçantë për secilin nga ne, për vendin, për rajonin, por edhe për komunitetin euro-amerikan të vlerave të përbashkëta demokratike, liridashëse dhe solidare. Të jemi krenarë që po i jetojmë këto ditë bashkërisht dhe kemi mundësi të japim kontribut për realizimin e synimeve dhe ndërtimin e ardhmërisë. Sot po korrim atë që kemi mbjellë gjatë dekadave pas nesh, bashkë dhe të palëkundur nga qëllimi", ka shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në "Facebook".

20 vjet nga konferenca e Rambujesë

Prishtinë, 6 shkurt (ER) - Të mërkurën u bënë dy dekada nga nisja e punimeve të konferencës së Rambujesë e cila ishte iniciuar nga Grupi i Kontaktit. Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se pas mbi një muaj negociatash që rezultuan pa marrëveshje të përbashkët, nisi edhe intervenimi i NATO-s që i dha fund luftës në Kosovë. "Republika e Kosovës nuk duhet të frikësohet asnjëherë nga dialogu kur pranë ka Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendet e tjera mike. Bashkë i kemi dhënë fund luftës dhe bashkë e kemi ndërtuar edhe paqen. Edhe në Rambuje, edhe sa herë që ne kemi qenë të bashkuar, gjithmonë kemi dalë fitimtarë. Prandaj, edhe paqen afatgjatë në rajonin tonë duhet ta ndërtojmë së bashku. Këtë duhet ta bëjmë për hir të brezave të rinj dhe një të ardhmeje më të mirë për popullin tonë dhe tërë Ballkanin Perëndimor", ka shkruar Thaçi.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Sylejman Selimi është intervistuar nga Prokuroria Speciale në Prishtinë

Gashi: Sylejman Selimi është intervistuar nga Specialja si i dyshuar

Për rreth dy orë ish-komandanti i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Sylejman Selimi, është intervistuar të mërkurën në Prishtinë nga Gjykata Speciale. Avokati i tij, Tomë Gashi, në një konferencë për media ka konfirmuar se klienti i tij është intervistuar në cilësinë e të dyshuarit. Megjithatë, Gashi nuk ka treguar se për çfarë është i dyshuar Sylejman Selimi

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 6 SHKURT - Ish-komandanti i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Sylejman Selimi, është intervistuar të mërkurën në Prishtinë nga Gjykata Speciale. Avokati i Sylejman Selimit, Tomë Gashi, ka treguar se klienti i tij është intervistuar në cilësinë e të dyshuarit. "Cilësia juridike për të cilën ai është marrë në pyetje ka qenë si i dyshuar. Do të thotë, jo dëshmitar i dyshuar, por i dyshuar. Ne shpresojmë se në të ardhmen prokurori të vendosë që mos ta lë këtë situatë thuajse pezull. Nuk besoj se kjo do të ndodhë shpejt. Pastaj në përfundim ata do të vijnë se çfarë do të vendosin juridikisht", ka thënë Gashi në një konferencë të përbashkët për medie me avokatin tjetër, Gregor Guy Smith, pas intervistimit të Sylejman Selimit. Ai ka sqaruar se Selimi është intervistuar në Prishtinë dhe i ka dhënë të gjitha shpjegimet në praninë e prokurorit dhe personave të tjerë të paraparë me ligj.

Avokati Gashi ka theksuar se marrja në pyetje e Sylejman Selimit ka zgjatur rreth dy orë si dhe ka qenë e formës së përgjithshme. "Z. Sylejman Selimi ka qenë i ftuar me ftesë të rregullt dhe të shkruar. Zyra e Prokurorit Special ka vendosur që ai të merret në pyetje këtu në Prishtinë. Nuk ka qenë kurrë kërkesa që ai të merret në Hagë. Ne besojmë se ajo ka qenë strategjia e prokurorit për zgjedhjen e vendit. Përndryshe, prokurori i çështjes ka qenë i pranishëm dhe personat e tjerë që janë të paraparë me ligj. Ai i ka dhënë të gjitha shpjegimet që janë kërkuar prej tij. Kështu që, nuk ka mbetur ndonjë situatë e pasqaruar pse këtu e jo në Hagë", është shprehur Gashi. Megjithatë, avokati Gashi nuk ka treguar se në cilin rast është i dyshuar Sylejman Selimi. "Unë nuk mund të them se për çfarë rasti konkretisht është marrë në pyetje, por ta themi pak pa e thyer ligjin, që ka qenë marrje në pyetje e përgjithshme dhe, po ashtu, edhe përgjigjet kanë qenë të tilla", është shprehur Gashi.

Ai ka folur edhe për kohën se kur mund të ngrehën akuzat e para nga Gjykata Speciale. Sipas tij, kjo kohë nuk është shumë e largët. "Sido që të jetë, askush nuk mund të thotë se kur mund të ngrehën akuzat e para. Por, duke pasur parasysh se gjykata është themeluar në gusht të vitit 2015 dhe është funksionalizuar që një kohë, nuk do të presim shumë javë, e jo muaj, dhe do të ngrehën akuzat e para, pa marrë parasysh kush do të jenë ata persona", është shprehur Gashi.

Më 25 janar të këtij viti Sylejman Selimi nga një panel i themeluar nga Këshilli Gjyqësor është liruar me kusht nga vuajtja e dënimit me gjashtë vjet burgim, pasi kishte kaluar mbi pesë vjet në burgim. Më 24 maj 2013 Selimi ishte arrestuar dhe më vonë ishte shpallur fajtor për një vepër penale të krimeve të luftës kundër popullatës civile nga Gjykata Themelore në Mitrovicë. Përveç Selimit, prokurori special në muajin e parë të këtij viti e ka intervistuar edhe ish-komandantin e UÇK-së për Zonën Operative të Drenicës, Sami Lushtaku, dhe ish-komandantin për Zonën Operative të Llapit, Rrustem Mustafën. Po ashtu, nga kjo gjykatë janë intervistuar edhe disa komandantë dhe ish-ushtarë të tjerë të UÇK-së.

Kosova kundërshton raportin e kreut të OKB-së, Antonio Guteres

PRISHTINË, 6 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka deklaruar se vlerësimi i sekretarit të përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Antonio Guteres, se problemi më i madh në raportet ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës është tarifa prej 100 përqindësh ndaj mallrave serbe, nuk është reflektim i së vërtetës. Sipas Haradinajt, vlerësimi i kreut të OKB-së buron nga raportet që i dërgon misioni i UNMIK-ut, me të cilin, sipas Haradinajt, Kosova e ka shkëputur komunikimin. "Kosova ka shkëputur komunikimin me UNMIK-un (Misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë) dhe nuk po komunikon me me të. Njerëzit e UNMIK-ut i shkruajnë këto letra dhe i dërgojnë atje. Nuk mendoj se është reflektim i të vërtetës", ka thënë Haradinaj.

Flet për "Epokën e re", Naser Rugova

LDK-ja s'bëhet pjesë e këtij dialogu

- Qeveria dhe partnerët e koalicionit e kanë futur vendin në krizë politike

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Naser Rugova, ka thënë se miratimi i Ligjit për dialog i bën paralelizëm Kushtetutës dhe institucioneve shtetërore. Ai ka thënë se procesin e dialogut me Serbinë duhet ta udhëheqin krerët e institucioneve shtetërore që kanë përgjegjësi kushtetuese e jo bashkëkryesues të niveleve të tjera. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Rugova ka deklaruar se LDK-ja nuk do të bëhet pjesë e këtij dialogu pa legjitimitet politik dhe elektoral. Ai ka thënë se Qeveria dhe partnerët e koalicionit e kanë futur vendin në krizë politike si dhe e kanë vënë në pikëpyetje miqësinë me partnerët tanë strategjikë. Prandaj, sipas Rugovës, zgjidhja e vetme janë zgjedhjet e reja

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 6 SHKURT - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Naser Rugova, ka thënë të mërkurën se është e papranueshme që pasuritë nëntokësore të Kosovës të negociohen në Bruksel. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se një gjë e tillë nuk bën as të mendohet. "'Trepça' është në Kosovë, e Kosovës ishte, është dhe do të mbetet g jithmonë. Nuk ka forcë që mund të na shtyjë që të negociojmë për pasuritë tona natyrore dhe nëntokësore. Pikë. Kjo nuk bën as të mendohet!", është shprehur ai. Kurse sa i përket taksës ndaj Serbisë, Rugova ka thënë se një veprim i tillë është dashur të analizohet mirë meqë, sipas tij, nuk ka masë, veprim politik apo juridik që e vë në pikëpyetje miqësinë dhe partneritetin strategjik me ShBA-në. "Falë ShBA-së jemi të lirë dhe të pavarur. Këtu s'ka hamendje!", ka deklaruar ai. Rugova ka thënë se dialogun me Serbinë duhet të udhëheqin krerët e institucioneve shtetërore që kanë përgjegjësi kushtetuese e jo bashkëkryesues të niveleve të tjera. Ai ka bërë me dije se LDK-ja nuk do të bëhet pjesë e këtij dialogu pa legjitimitet politik dje elektoral. "LDK-ja tani vetëm se e ka qëndrimin zyrtar: ne jemi kundër një dialogu me improvizime, paralelizma dhe mungesë legjitimiteti politik dhe elektoral. Kosova është shtet, nuk është OJQ. Në dialog udhëheqin krerët e institucioneve, konkretisht kryeministri, e jo bashkëkryesues në nivele të tjera si kryetarë komunash, ku njëri bashkëkryesues vjen nga partia e katërt e amputuar nga një grup parlamentar pa legjitimitet elektoral, tjetri nga partia e shtatë parlamentare. Ky është degradim institucional dhe nënçmim i institucioneve të shtetit. LDK-ja kundërshton fuqishëm këtë improvizim dhe nuk bëhet pjesë e kreaturave të tilla antikushtetuese", ka theksuar Rugova. Ai ka thënë se qeveria dhe partnerët e koalicionit e kanë futur vendin në krizë politike si dhe e kanë vënë në pikëpyetje miqësinë me partnerët tanë strategjikë prandaj, sipas Rugovës, zgjidhje e vetme janë zgjedhjet. "Është qeveri pa legjitimitet, me skandale e vendime paradoksale. E ka vënë në pikëpyetje miqësinë me partnerët tanë strategjikë. Zgjidhje e vetme mbesin zgjedhjet", ka deklaruar ai, duke shtuar se opozita ka tentuar t'i demaskojë këto politika dhe veprime të dëmshme duke thirrur dhjetëra seanca të jashtëzakonshme dhe debate parlamentare. "Me një fjalë, kemi tentuar dhe po tentojmë ta ruajmë fytyrën e këtij shteti të ri të krijuar me sakrificë të shumë brezave!", është shprehur Rugova.

"Epoka e re": *Z. Rugova, si i komentoni zhvillimet e fundit në skenën politike, përkatësisht*

pa legjitimitet politik dhe elektoral

miratimin e Ligjit për Dialog dhe ecurinë e këtij procesi?
Rugova: Vlerësoj se krerët e institucioneve të shtetit tonë me politika të papjekura dhe me një diskrepancë të madhe mendimesh dhe veprimesh politike e kanë rrëzuar për tokë imazhin e vendit tonë. Dëshmi e improvizimeve të radhës së këtij pushteti dhe një paterice opozitare është miratimi i Ligjit për dialog që i bën paralelizëm Kushtetutës dhe institucioneve shtetërore si kategori kushtetuese.

"Epoka e re": *LDK-ja ka kundërshtuar miratimin e këtij ligji dhe është shprehur kundër pjesëmarrjes në dialog pavarësisht prej kërkesave të faktorit ndërkombëtar. Mund të ndryshoni qëndrim në rrugëtim e sipër të këtij procesi?*
Rugova: LDK-ja tani vetëm se e ka qëndrimin zyrtar: ne jemi kundër një dialogu me improvizime, paralelizma dhe mungesë legjitimiteti politik dhe elektoral. Kosova është shtet, nuk është OJQ. Në dialog udhëheqin krerët e institucioneve, konkretisht kryeministri, e jo bashkëkryesues në nivele të tjera si kryetarë komunash, ku njëri bashkëkryesues vjen nga partia e katërt e amputuar nga një grup parlamentar pa legjitimitet elektoral, tjetri nga partia e shtatë parlamentare. Ky është degradim institucional dhe nënçmim i institucioneve të shtetit. LDK-ja kundërshton fuqishëm këtë improvizim dhe nuk bëhet pjesë e kreaturave të tilla antikushtetuese.

"Epoka e re": *Cili është qëndrimi juaj si parti sa i përket taksës ndaj Serbisë? Mendoni se duhet të mbetet në fuqi apo të hiqet ashtu siç po kërkon ShBA-ja?*
Rugova: Disa herë kryetari i LDK-së është deklaruar për taksën. Një veprim i tillë është dashur të analizohet mirë. Nuk ka masë, veprim politik apo juridik që e vë në pikëpyetje miqësinë dhe partneritetin strategjik me ShBA-në. Falë ShBA-së jemi të lirë dhe të pavarur. Këtu s'ka hamendje. Miqësia e përhershme me ShBA-në është fundament politik i LDK-së dhe amanet i presidentit Rugova.

"Epoka e re": *Pse atëherë LDK-ja nuk e dëgjoi ShBA-në për t'u bërë pjesë e dialogut?*
Rugova: LDK-ja e ka arsyetuar mospjesëmarrjen në këtë proces. Kemi argumentuar arsyet dhe hezitimet tona. Ne jemi në linjë të njëjtë me ShBA-në dhe insistojmë që dialogun ta udhëheqin institucionet shtetërore që kanë përgjegjësi kushtetuese.

"Epoka e re": *Duke i pasur parasysh deklarimet e fundit rreth statutit të "Trepçës", a ka rrezik që ajo të bëhet pjesë e dialogut me Serbinë?*
Rugova: "Trepça" është në Kosovë, e Kosovës ishte, është dhe do të mbetet gjithmonë. Nuk ka forcë që mund të na shtyjë që të negociojmë për pasuritë tona natyrore dhe nëntokësore. Pikë. Kjo nuk bën as të mendohet.

"Epoka e re": *LDK-ja në vazhdimësi ka kërkuar zgjedhje të reja. Pse mendoni se zgjedhjet janë e vetmja zgjidhje?*
Rugova: Kjo qeveri dhe këta partnerë të koalicionit e kanë futur vendin në krizë politike dhe popullin në depresion kolektiv. E kanë degraduar imazhin e vendit dhe me papjekuri politike dhe ide aventureske kanë vënë në pikëpyetje edhe rendin kushtetues dhe integritetin territorial të vendit. Janë qeveri pa legjitimitet, me skandale e vendime paradoksale. E ka vënë në pikëpyetje miqësinë me partnerët tanë strategjikë. Zgjidhje e vetme mbesin zgjedhjet.

"Epoka e re": *A mund t'i sigurojë LDK-ja votat për ta rrëzuar këtë qeveri?*
Rugova: Ne kemi bërë përpjekje që t'i sigurojmë votat për rrëzimin e kësaj qeverie e cila është më e dobëta që nga çlirimi. Deri tani nuk kemi arritur ta bëjmë këtë, por do të vazhdojmë me opozitarizmin tonë dhe me presionin publik.

"Epoka e re": *Çfarë vlerësimi keni për punën e deritanishme të koalicionit PAN dhe për rolin e opozitës?*
Rugova: Është qeveri e skandaleve, e vendimeve arbitrare dhe joligjore, mentalitet feudal i qeverisjes së partnerëve të këtij koalicioni, mungesë idesh e vizioni, ndërhyrje politike në drejtësi, korrupsioni në grafikonin më të lartë vlerësuar nga institucione vendore dhe ndërkombëtare, politizim i skajshëm dhe degradim i institucioneve, dështim në politikat zhvillimore, në liberalizimin e vizave, ulje e imazhit të vendit dhe rrënim i miqësisë me partnerët strategjikë. Si opozitë kemi tentuar t'i demaskojmë këto politika dhe veprime të dëmshme, kemi thirrur dhjetëra seanca të jashtëzakonshme dhe debate parlamentare. Me një fjalë, kemi tentuar dhe po tentojmë ta ruajmë fytyrën e këtij shteti të ri të krijuar me sakrificë të shumë brezave!

PSD-ja kërkon të rritet paga minimale

Prishtinë, 6 shkurt (ER) - Nënkryetari dhe deputeti i Partisë Socialdemokrate (PSD), Visar Ymeri, ka kërkuar të mërkurën rritjen e pagës minimale në Republikën e Kosovës. Në një konferencë për medie, ai ka thënë se paga minimale duhet të ndryshojë në mënyrë që të përmirësohet pozita e atyre që kanë më pak në shoqërinë e Kosovës. "Paga minimale prej 170 eurosh për të punësuarit mbi moshën 35-vjeçare dhe 130 euro për ata nën këtë moshë nuk mbulon as për së afërmi nevojat e punëtorit buzë varfërisë, përderisa mijëra punëtorë mbajnë nga dy puna ose punojnë mbi tetë orë në ditë vetëm sa për t'i plotësuar nevojat ekzistenciale", ka thënë Ymeri.
Duke sqaruar arsyen e thirrjes së interpelancës parlamentare për këtë çështje, Ymeri ka deklaruar së kjo interpelancë do të shërbejë edhe si nxitje e diskutimit publik për këtë çështje. Ymeri ka rikujtuar se që prej se ka hyrë në fuqi Ligji për Këshillin Ekonomik-Social (KES), paga minimale është vendosur vetëm një herë në vitin 2011. "Prej atëherë, kjo pagë ka vazhduar të jetë e njëjta, edhe pse ekonomia reale dhe ndikimi social i saj ka ndryshuar në mënyrë drastike", ka thënë nënkryetari i PSD-së, duke shtuar se gjatë kësaj kohe pagat në sektorin publik janë rritur së paku dy herë, si dhe për të tretën herë së fundi me Ligjin për pagat. "Që nga viti 2011 paga minimale ka vazhduar të jetë e njëjta, ndërkaq pagat e sektorit publik janë rritur dy herë. Në vitin 2017 Këshilli Ekonomik Social që ka për detyrë ta propozojë shumën e pagës minimale, ka propozuar që paga minimale të rritet 250 euro, mirëpo që është kërkesë e shpërfillur nga Qeveria", ka deklaruar ai. Sipas Ymerit, botërisht është dëshmuar se paga minimale ka shumë efekte pozitive, pasi rritja e saj e ul pabarazinë në të ardhura dhe e rritë mirëqenien e gjithëmbarshme. Ai ka folur edhe mbi atë se si paga minimale ndikon në dimensionin ekonomik, përveç atij social, pasi rritja e saj rritë sasinë e parave në treg, fuqinë blerëse, më pas edhe qarkullimin agregat të parasë në ekonomi, rrjedhimisht vlerat e ekonomisë në përgjithësi.
Deputeti i Partisë Socialdemokrate ka bërë me dije se interpelanca e thirrur për këtë temë do të përqendrohet në efektet sociale dhe ekonomike, por edhe në metodologjinë e llogaritjes së pagës minimale. "Përmes debatit do të kuptohet edhe joqëndrueshmëria e kundërshtimeve për rritjen e pagës minimale", ka shtuar ai.
Në fund të konferencës, Ymeri ka shprehur mbështetjen dhe gatishmërinë e Partisë Socialdemokrate për bashkëpunim me sindikatat e punëtorëve, me qëllim që ata të kenë rol vendimmarrës dhe që të respektohet puna e tyre.

Veseli nënshkruan vendimin për statutin e "Trepçës"

Prishtinë, 6 shkurt (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, njëherësh lider i koalicionit qeverisës, Kadri Veseli, ka nënshkruar të mërkurën vendimin e miratuar nga Kuvendi i Kosovës për statutin e "Trepçës". Një ditë më parë zëdhënësja e BE-së, Maja Kocijançiq, ka thënë se çështja e "Trepçës" duhet të zgjidhet nëpërmjet marrëveshjes gjithëpërfshirëse për normalizimin e dialogut ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit në Bruksel. Ndaj kësaj deklarate pati reaguar Veseli. "Trepça as nuk ka qenë, as nuk është dhe as nuk do të jetë çështje e hapur në dialogun me Serbinë. Me këtë gjuhë BE-ja është duke e rrënuar çdo perspektivë të dialogut dhe fqinjësisë së mirë. 'Trepça' është e drejtë natyrore e shtetit të Kosovës. Sot dhe përgjithmonë", ka thënë Veseli.

Autostrada e Dukagjinit përfundon brenda katër vjetëve

Prizren, 6 shkurt (ER) - Pal Lekaj, ministër i Infrastrukturës dhe Transportit, të mërkurën mori pjesë në dëgjimin publik me prizrenasit për autostradën e Dukagjinit, që shënon edhe fundin serisë së debateve publike për këtë projekt.

Ministri Lekaj shtjelloi rëndësinë e këtij projekti madhor dhe u premtoi prizrenasve se të gjitha sugjerimet dhe propozimet e tyre do të merren parasysh dhe shqyrtohen me kujdes. I pari i Infrastrukturës dhe Transportit tha se Prizreni do ta ketë gjithherë mbështetjen e institucioneve qendrore dhe ky projekt është dëshmia më e mirë për këtë.

Pjesëmarrësit e këtij debati u informuan në detaje për projektin nga kompania projektuese, kurse me sugjerimet e tyre dhanë kontribut për kompletim të projektit që ai të jetë sa më në shërbim të qytetit të tyre dhe zhvillimit të Kosovës. Ata u shprehën falënderues që për herë të parë u është dhënë mundësia të jenë pjesë e procesit projektues të një projekti kaq të rëndësishëm.

Autostrada e Dukagjinit është projekti më i madh që po bëhet për lidhjen e Kosovës me korridoret pan evropiane. Kjo autostradë do të jetë e gjatë rreth 91 kilometra dhe fillon nga Istogu, kalon nëpër Pejë, Deçan, Junik, Gjakovë, Rahovec dhe përfundon në Prizren, ku lidhet me autostradën "Ibrahim Rugova". Autostrada e Dukagjinit do të fillojë këtë vit dhe do të përfundojë për katër vjet.

Vlora Dumoshi takon disa të rinj, diskutojnë për problemet e tyre

Prishtinë, 6 shkurt (ER) - Anëtarja e Kryesisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), njëherësh asambliste e Kuvendit Komunal të Prishtinës, Vlora Dumoshi, ka pritur të mërkurën në takim disa të rinj të cilët i kanë adresuar problemet e tyre në këtë parti. Sipas komunikatës së LDK-së, studentë e maturantë të Prishtinës e rrethinës, kanë shtruar dhe diskutuar shumë tema që prekin të ardhmen e tyre, si punësimin, cilësinë e shkollimit, jetën në kohë të lirë; pakënaqësitë me trajtimin e të rinjve dhe nevojave të tyre nga pushteti komunal i Prishtinës dhe institucionet qendrore.

Të rinjtë u njoftuan nga Dumoshi për organizimin dhe programin e LDK-së, për hapësirën që kjo parti ofron për të rinjtë, për të ndërtuar një vend që ofron perspektivë, shoqëri evropiane dhe rini evropiane. "Të rinjtë e Prishtinës çdo ditë po adresohen me besim dhe entuziazëm në Lidhjen Demokratike, si parti e vlerave dhe e qeverisjes së mirë. Znj. Dumoshi, së bashku me Sami Salihun, kryetarin e Degës së Katërt të Forumit të Rinisë të LDK-së, konstatuan se besimi i shtuar i të rinjve në LDK dhe në forumin e saj rinor, dhe bashkëbisedimi me të rinjtë, janë vlerë e shtuar e LDK-së. LDK-ja është e përkushtuar për të rinjtë dhe është e përgjegjshme të punojë së bashku me ta për të ardhmen e tyre", është thënë në komunikatën e LDK-së.

203 raste emergjente në QKUK

Prishtinë, 6 shkurt (ER) - 203 raste ka pasur në 24 orët e fundit në Klinikën Emergjente në QKUK. Nga numri i përgjithshëm i rasteve, 34 ishin në dhomën e kujdesit të avancuar emergjent. Kishte 49 vizita emergjente kirurgjike, 75 raste internistike dhe 31 raste që konsultuan dhe morën shërbime nga ortopedi.

Në dhomën e intervenimeve të vogla kirurgjike kishte 14 raste, kurse 12 raste kërkuan ndihmë mjekësore si pasojë e aksidenteve në trafik.

Në Emergjencën e Klinikës së Pediatrisë në 24 orët e fundit ka pasur gjithsej 69 fëmijë që kanë kërkuar ndihmë mjekësore. Ndërkaq në Ambulanten Specialistike ka pasur gjithsej 75 raste, prej tyre 14 janë pranuar për trajtim të mëtejmë.

Dënohet abuzimi i 16-vjeçares nga Drenasi

Një 16-vjeçare nga Komuna e Drenasit dyshohet se është abuzuar seksualisht nga mësimdhënësi (Sh. Xh.) e më pas është dhunuar nga hetuesi policor (V. V.) tek i cili kishte shkuar për ta denoncuar rastin e abuzimit. Lidhur me këtë rast, zyrtari policor është arrestuar, kurse mësimdhënësi është suspenduar nga puna. Rasti i të miturës është dënuar nga përfaqësuesit e institucioneve shtetërore dhe të shoqërisë civile

PRISHTINË, 6 SHKURT (ER) - Nën dyshimin se ka kryer vepër penale të dhunimit, keqpërdorimit seksual dhe keqpërdorimit të pozitës zyrtare, është arrestuar një zyrtar policor me inicialet V. V ndaj të cilit është shqiptuar masa e ndalimit për 48 orë. Punonjësi i Stacionit Policor në Drenas, me gradën e rreshterit (V. V.), dyshohet se ka keqpërdorur dhe dhunuar nxënësen 16-vjeçare nga Komuna e Drenasit. Sipas raportimeve të medieve, e mitura kishte shkuar në polici për ta denoncuar profesorin e saj (Sh. Xh.), por në vend të gjetjes së ndihmës, ajo ka gjetur një "padron" skllavërues policor.

Pas marrjes së deklaratës, fotografimit të zhveshur të viktimës dhe ekspertizës mjekoligjore, hetuesi (V. V.) nën kërcënim dhe shantazh e kishte detyruar 16-vjeçaren të bënte seks me të. Pas shfrytëzimit seksual për më shumë se një vit, vajza kishte mbetur shtatzënë, por hetuesi policor e kishte detyruar të miturën të abortonte në ordinancën e gjinekologut me inicialet F. A në Prishtinë. Lidhur me këtë rast, përveç arrestimit të zyrtarit policor, është suspenduar nga puna mësimdhënësi me inicialet Sh. Gj.

Rasti i të miturës është dënuar nga përfaqësuesit e institucioneve shtetërore dhe shoqërisë civile.

Për këtë çështje kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka mbajtur të mërkurën një konferencë të jashtëzakonshme për medie, në të cilën ka dënuar këtë rast. Ai ka treguar se profesori (Sh. Xh.) është suspenduar nga puna në Gjimnazin "Gjergj Kastrioti-Skënderbeu" në Drenas. Lladrovci ka thënë se ky vendim është marrë në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit të kësaj komune. "Ftojmë organet e drejtësisë që ta ndjekin këtë rast sepse ne besojmë në gjykatat tona", ka thënë Lladrovci.

Edhe ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka dënuar rastin e abuzimit të nxënëses 16-vjeçare nga mësimdhënësi i saj në Komunën e Drenasit. Ai u ka bërë thirrje organeve të drejtësisë që të merren seriozisht me këtë rast.

Ish-presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, ka thënë se është e shokuar dhe thellësisht e irrituar me lajmet mbi abuzimin e dyfishtë seksual të vajzës nga Drenasi. "Pas abuzimit të saj në shkollë, e cila do të duhej të ishte shtëpi e dytë për fëmijët tanë, ajo iu drejtua për ndihmë një polici i cili do të duhej ta mbronte atë. Por, shkolla u shndërrua në ferr, ndërsa polici u bë abuzues. E gjithë kjo ndodhi sepse dy individë shpërfaqen të keqen e tyre duke ushtruar vazhdimisht dhunë të egër, mizore e barbare mbi një të mitur", ka shkruar Jahjaga në llogarinë e vet në "Facebook". Ajo ka thënë se individët e përfshirë në këtë rast nuk e kanë vendin as në shkollë e as në polici. "Shkollat tona nuk janë vende krimi e policët tanë nuk janë kriminelë. Individët që dhunojnë fizikisht e psikikisht vajzat e djemtë tanë, duke kryer vepra të tilla çnjerëzore, e kanë vendin prapa grilave. U bëj thirrje institucioneve të drejtësisë që sa më parë ta ndriçojnë këtë rast dhe kryesit e këtyre krimeve ta marrin dënimin e merituar", ka thënë Jahjaga.

Abuzimi i 16-vjeçares është dënuar edhe nga ambasadorja e Kosovë në ShBA, Vlora Çitaku, nga deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe nga zyrtarë të tjerë. Kundër dhunës dhe abuzimit ndaj femrave janë paralajmëruar dy protesta, njëra do të mbahet sot (e enjte) para Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë në Prishtinë në orën 12:00, tjetra të premten në orën 12:00 në Drenas.

Mustafa e Kurti: Konferenca ndërkombëtare për Kosovën, ide e papranueshme

EPOKA E RE — Qendresa RAMA

PRISHTINË, 6 SHKURT - Partitë opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Lëvizja Vetëvendosje (LV), kanë njoftuar se kryetarët e dy partive, Albin Kurti dhe Isa Mustafa, kanë biseduar gjatë një takimi për zhvillimet e fundit politike në vend. Siç thuhet në komunikatën për media, të dy kryetarët kanë vlerësuar se negocimi i çfarëdo marrëveshje finale me Serbinë duhet bërë me një formulë parlamentare që garanton unitet të gjerë politik. "Kuvendi i Kosovës është institucioni i vetëm që ushtron autoritetin e përcaktimit të asaj çfarë mund dhe nuk mund të negociohet përmes një vendimmarrje transparente dhe më së paku një shumice të kualifikuar prej 2/3. Dialogu duhet të zhvillohet nga një qeveri e cila ka legjitimitet politik dhe e përfaqëson shumicën parlamentare. Platforma me qëllime dhe parime duhet të jetë legjitime, po ashtu përmes një shumice të kualifikuar prej 2/3 e deputetëve të Kuvendit", është thënë në komunikatën për media.

Po ashtu, është bërë me dije se negocimi i çfarëdo çështjeje që është fundament kushtetues dhe element i shtetit të Kosovës, siç janë territori, institucionet kushtetuese, popullsia, resurset natyrore, është i papranueshëm dhe ato nuk mund të bëhen objekt i negocimit me Serbinë.

Mustafa dhe Kurti kanë vlerësuar se thirrja e një konference ndërkombëtare për një marrëveshje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të jetë e panevojshme dhe e papranueshme meqenëse do të hapte rrugë për ndërhyrje të Rusisë dhe Kinës në një proces të pavarësimit të Kosovës. "Kosova është shtet i pavarur dhe shtetësia e saj nuk mund të rinegociohet në asnjë element përbërës të saj. Kosova do të mbetet shtet i tillë në të drejtën ndërkombëtare me apo pa njohjen e Serbisë. Askush nuk mund ta rivlerësojë atributin e shtetit të Kosovës si produkt i rezistencës dhe luftës së popullit për liri, intervenimit të NATO-s dhe konsensusit të prerë të demokracive perëndimore për një gjë të tillë", është theksuar në komunikatën e dy partive politike.

Sektori bankar synon ta rrisë qasjen në financa dhe cilësinë e shërbimeve në biznese

PRISHTINË, 6 SHKURT (ER) - Bankat komerciale të Kosovës janë duke vënë në dispozicion tërë kapacitetet e tyre për ta rritur financimin e sektorit privat dhe ekonomive familjare në mënyrë që Kosova të ketë rritje më të madhe ekonomike dhe të nxitet punësimi në vend. Kështu thuhet në njoftimin e Shoqatës së Bankave të Kosovës. Sipas këtij njoftimi, gjatë vitit 2018, sektori bankar në Kosovë ka aprovuar 1,367.1 milionë euro kredi nga të cilat 816.4 milionë euro ishin për sektorin privat, ndërsa 550.7 milionë euro ishin për ekonomitë familjare. "Bankat e vendit nga gjithsej kreditë e lëshuara, 59.7 për qind të kësaj shume u kanë dhënë bizneseve, duke vënë kapitalin në dispozicion të zgjerimit të kapaciteteve të këtyre bizneseve dhe duke nxitur punësimin. Kreditimi i bizneseve bëhet sipas kërkesës së tregut e cila vjen si rrjedhojë e strukturës ekonomike të vendit. Kjo reflektohet edhe në kreditimin e sektorëve të ndryshëm ku sektori i tregtisë është më i krediituar se sektorët e tjerë me një përqindje prej 48.8 përqindësh të gjithsej kredive për sektorin privat. Vlen të ceket se sektori i ndërtimtarisë ka, po ashtu, një peshë më të madhe në këtë aspekt, me një pjesëmarrje prej 9 përqindësh", është thënë në komunikatën e ShBK-së.

Sipas kësaj komunikate, sektorë të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit, siç është sektori i bujqësisë dhe prodhimtarisë, kanë shënuar rritje të konsiderueshme në vlerë të përgjithshme, respektivisht 67.6 milionë euro për bujqësinë dhe 218.1 milionë euro për sektorin prodhues, por pjesëmarrja e tyre në gjithsej kreditë mbetet relativisht e ulët dhe e pandryshuar ndër vite. Sipas ShBK-së, norma mesatare e interesit për kredi në fund të vitit 2018 ka shënuar 5.99 për qind përderisa edhe pjesëmarrja e kredive joperformuese mbetet e ulët në vetëm 2.7 për qind. ShBK-ja ka njoftuar se në këtë drejtim, edhe në vitin 2019, sektori bankar synon që ta rrisë qasjen në financa dhe ta rrisë cilësinë e shërbimeve në shërbim të bizneseve dhe ekonomive familjare në vend.

Haradinaj viziton kompaninë 'Vipa Chips': Taksa ndikoi në rritjen e shitjeve të produkteve vendore

PRISHTINË, 6 SHKURT (ER) - "Vipa Chips është brend i besueshëm, që fillon në arat e Pestovës dhe mbështetet në traditën e kultivimit të patates. Produktet e Pestovës kanë depërtuar edhe në tregjet më të avancuara", ka thënë kryeministri Ramush Haradinaj pas vizitës që ka bërë në këtë kompani prodhuese, e cila ka mbi 212 të punësuar të rregullt dhe 35 shtesë gjatë zezonës.

Haradinaj ka thënë se nga pronari i kësaj kompanie, Bedri Kasumi, është njoftuar se impakti i reformave fiskale ka qenë i madh dhe klima për veprimtarinë prodhuese në vend është më e volitshme si asnjëherë më parë. "Pas vendimit për taksën është rritur përqindja e shitjes për muaj, numri i të punësuarve dhe eksporti i prodhimeve vendore. Prodhuesit vendorë po ringjallen dhe në vitin e ekonomisë ata kanë hyrë me rezultate impresive", ka thënë kryeministri Haradinaj.

Nënshkruhet kontrata për investimet në hekurudhë

Kryeshefi ekzekutiv i "Infrakos"-it, Agron Thaçi, dhe drejtori gjeneral i GCF-së, Eduardo Rossi, kanë nënshkruar kontratën "Rehabilitimi i linjës 10 hekurudhore, të segmentit Fushë-Kosovë - Hani i Elezit". Punimet për këtë linjë parashihen të zgjasin deri në vitin 2021

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 6 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, mori pjesë në ceremoninë e nënshkrimit të kontratës komerciale ndërmjet "Infrakos"-it dhe GCF (Generale Construzioni Ferrovarie) për rehabilitimin e linjës së 10 hekurudhore, segmenti Fushë-Kosovë - Hani i Elezit, nënshkrim ky që u bë nga Agron Thaçi, kryeshef ekzekutiv në Hekurudhat e Kosovës dhe Edoardo Rossi, drejtor gjeneral i GCF-së. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj ka thënë se sot është një ditë feste në Kosovë, për faktin se fillojnë punimet për renovimin, rehabilitimin, aftësimin e njërit prej sektorëve të rëndësishëm, atë të hekurudhave të Kosovës, sektorit 10, që është Fushë-Kosovë - Hani i Elezit.

Kryeministri Haradinaj ka sqaruar se këto punime do të zgjasin 24 muaj, që i bie se në fillim të vitit 2021 Kosova do të ketë hekurudha të kualitetit të pranueshëm, kompatibile dhe në funksion të qarkullimit të mallrave dhe të njerëzve, por edhe të lidhjeve ekonomike jo vetëm me Maqedoninë Veriore në këtë rast, por edhe të ekonomive të rajonit. "Ky është një investim i përbashkët, investon populli i Kosovës nga buxheti i vet, po ashtu investon edhe BE-ja përmes fondeve të IPA-s për aftësimin e hekurudhave tona", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke uruar për këtë të arritur të sotme. Ai ka theksuar se hekurudhat kanë edhe dy seksione të tjera të nevojshme dhe se edhe për ato së shpejti do të ketë nënshkrime të kontratave.

Haradinaj ka pohuar se për këto seksione puna do të ndodhë më shpejt dhe se në pranverë të vitit 2021 jo vetëm se do të jetë i përmbyllur seksioni nga Fushë-Kosova deri në Han të Elezit, por do të jenë të përfunduara edhe deri në Merdare. "Kosova, më në fund, do ta ketë rrjetin hekurudhor funksional kualitativ", ka deklaruar kryeministri Haradinaj, duke shtuar se do të ishte një lajm i gëzueshëm nëse do të kishte një hekurudhë që do ta lidhte Kosovën me Portin e Durrësit, duke shpresuar se në një të ardhme kjo edhe do të arrihet.

Kryeministri Haradinaj kaka thënë se e mira e kësaj pune është se do të ketë vende të punës dhe gjenerim ekonomik. Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka thënë se sot po fillon diçka e re për sistemin hekurudhor për vendin dhe se pas gjysmë shekulli do të ndodhin investime në modernizimin e trasesë, nga ku do të kalojnë më shpejt dhe me kosto më të ulët trenat me shpejtësi gati 150 kilometra në orë. "Sot do të fillohet implementimi i projektit prej 210 milionë eurosh, para të siguruara nga Qeveria e Kosovës përmes Bankës për Rindërtim dhe Zhvillim", është shprehur Lekaj.

Agron Thaçi, kryeshef ekzekutiv në Hekurudhat e Kosovës, ka theksuar se kjo është një ditë e veçantë që po kurorëzohet me një lidhje të kontratës për rehabilitimin e linjës hekurudhore, projekt ky i cili do të ketë efekt jo vetëm në ekonominë dhe mirëqenien tonë, por edhe në rajon dhe më gjerë. "Ky projekt do të na mundësojë të krijojmë lëvizje më të lehta dhe më të lira të qytetarëve dhe të mallrave. Javën e ardhshme do të lansohet edhe projekti tjetër prej 40 kilometrave dhe deri në pjesën e parë të vitit 2021 do t'i kemi të përfunduara afër 100 kilometra", ka thënë Thaçi, duke theksuar se nga ky projekt Kosova do të përfitojë në të gjitha fushat, duke filluar nga ekonomia, aspekti social dhe ai mjedisor.

Luigi Brusa, shef i Sektorit nga Seksioni i Bashkëpunimit i Zyrës së Komisionit Evropian në Kosovë, ka deklaruar se janë duke nisur një udhëtim së bashku i cili do të zhvillohet në tri faza dhe se me këtë ata janë duke bashkuar njerëz. "Jemi duke nisur një udhëtim, por ky është një udhëtim i vërtetë, sepse do të ketë një ndikim shumë pozitiv nga ky investim në ekonominë e Kosovës. Do të krijohen rreth 160 vende pune", ka vlerësuar Brusa.

Blerja pa tender e mallrave dhe shërbimeve cenon barazinë e sektorëve

PRISHTINË, 6 SHKURT (ER) - Prokurimi "në-shtëpi" paraqet një sferë delikate e cila duhet rregulluar me urgjencë përmes dispozitave të cilat parashohin për trajtim të barabartë të sektorëve publikë dhe privatë në aktivitete të prokurimit, duke mundësuar për konkurrencë të drejtë dhe qasje të barabartë. Kështu u tha në një tryezë të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë.

Zyrtari i Politikave të Odës Amerikane, Albion Ujkashi, ka theksuar se prokurimi "në-shtëpi", gjegjësisht blerja e produkteve apo shërbimeve nga ndërmarrjet publike, pa iu nënshtruar procedurave të prokurimit publik, përbën një temë e cila mbetet subjekt i kritikave nga asociacionet e biznesve, shoqëria civile, por edhe nga institucionet ndërkombëtare, pasi që praktikat e zbatuara për dhënien e kontratave konsiderohen të jenë në kundërshtim me dispozitat kushtetuese dhe ligjore për barazinë e sektorëve publikë dhe privatë, aq më tepër kur ndërmarrjet publike dhe në pajtim me Ligjin për Ndërmarrje Publike duhet të trajtohen të barabarta me ato të sektorit privat.

Kryetari i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, Osman Vishaj, ka thënë se prokurimi "në-shtëpi" paraqet një fushë për të cilën ky institucion është detyruar që në të kaluarën të ndërmarrë hapa për ta mundësuar interpretimin e dispozitave relevante në mënyrë që të kushtëzohet dhe rregullohet kjo çështje e cila parashihet dhe është e lejueshme me ligjin në fuqi mbi prokurimin publik. Megjithatë, ai pranoi se prokurimi "në-shtëpi" paraqet një sferë e cila duhet marrë në konsideratë për t'u adresuar tutje, gjë që mund të bëhet më saktësisht përmes hartimit të ligjit të ri mbi prokurimin, ku dhe ftoi komunitetin e biznesit që të angazhohet për dhënie të komenteve dhe rekomandimeve në këtë drejtim.

Udhëheqësi i Institutit të Ballkanit për Prokurim Publik, Ilaz Duli, ka theksuar se prokurimi në përgjithësi duhet analizuar nga tri këndvështrime, përkatësisht nga ai legjislativ, institucional dhe implementues. Ai ka theksuar se

problemet mbi prokurimin "në-shtëpi" në Kosovë janë bërë evidente në vitin 2016 me interpretimin e Nenit 9.4 të Ligjit të Prokurimit Publik nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, andaj përbën një çështje e cila drejtpërsëdrejti e dëmton konkurrencën e drejtë dhe duhet patjetër të rregullohet në mënyrë të duhur përmes një Ligji të ri të Prokurimit Publik, apo ndryshimit të interpretimit nga KRPP-ja.

Kryeministri shkon për ngushëllime në familjen e Herticëve

Prishtinë, 6 shkurt (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka shkuar të mërkurën për ngushëllime në familjen e Herticëve, me rastin e ndarjes nga jeta të Ahmet Aliut. "Në familjen e Herticëve, për të shprehur ngushëllime për ndarjen nga jeta të Ahmet Aliut. Gjatë viteve '90 Herticët dy shtëpitë e veta i kishin vënë në funksion të shkollës shqipe", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Policët në Deçan dalin me armë të gjata në punë

Deçan, 6 shkurt (ER) - Të gjithë zyrtarët policorë në Komunën e Deçanit në ndërrimet ditore në punë do të dalin me armë të gjata. Ky vendim është marrë për shkak të rasteve të grabitjeve të armatosura në këtë komunë. "Të dashur qytetarë, të gjithë jeni në dijeni mbi shtimin e veprave penale 'Grabitje me armë zjarri' që ka përfshirë pothuaj mbarë shtetin e Kosovës. Në këtë çështje nuk është imun as rajoni i Pejës, ku pothuaj çdo ditë po ndodhin raste të grabitjes së bankave, institucioneve mikro-financiare, bizneseve të mëdha, bastoreve, edhe dyqaneve të tjera. Raste të tilla kanë ndodhur edhe në zonën tonë të Deçanit. Nga data 4. 2. 2019, me qëllim të ruajtjes së pasurisë shtetërore dhe asaj private, kam marrë vendim që zyrtarët policorë në të gjitha ndërrimet ditore 24/7 të dalin në detyrë më armë të gjata", është thënë në njoftimin e lëshuar për media nga komandanti i Stacionit Policor në Deçan, Nysret Xhurkaj. Ai ka bërë me dije se ky vendim është marrë me qëllim që qytetari të ndihet më i sigurt për jetën dhe pasurinë personale. "Ne do të jemi afër jush, për sigurinë tuaj, sepse qytetarët e vendit tim janë të shenjtë për mua. Do të vazhdojë të na përcjellë motoja 'Policia është populli, populli është policia'", është thënë në njoftimin e lëshuar nga komandanti i Stacionit Policor në Deçan, Nysret Xhurkaj.

FSK-ja shkatërron ortekët e borës në Brezovicë

Shtërpcë, 6 shkurt (ER) - Në një lartësi mbidetare mbi 2 230 metra dhe mot të keq, ekipet e kërkim-shpëtimit dhe të çminimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës kanë realizuar me sukses misionin e tyre për largimin e ortekëve të borës. Ishte mision i vështirë, por i realizueshëm për ekipet profesionale të FSK-së. Këta ortekë, për fat të keq, para disa ditësh morën edhe jetë njerëzish.

Pas vlerësimit të situatës nga ekipet e kërkim-shpëtimit të FSK-së, ekipet e çminimit, me të gjitha kushtet e vështira, kanë filluar punën më 2 shkurt për largimin e ortekëve të rrezikshëm të borës në kompleksin turistik në Brezovicë. "Së pari shkatërruan ortekun e parë me eksploziv, i cili paraqiste rrezik të madh për krijimin e një orteku edhe më të madh dhe shumë të rrezikshëm për qytetarët. Për shkak të motit shumë të vështirë dhe erërave të forta, deri në 60km/h, operacioni është dashur të ndërpritet. Operacioni ka vazhduar më 4. 2. 2019, me ç'rast është larguar edhe orteku i dytë. Sipas vlerësimeve, për momentin nuk ka rrezik për lëvizje të ortekëve mirëpo, duke u bazuar në kushtet atmosferike të cilat mbretërojnë në këtë pjesë, mund të krijohen ortekë të cilët mund të paraqesin rrezik për jetën e qytetarëve", është thënë në njoftimin për media të FSK-së.

Sipas këtij njoftimi, vështirësitë në terren kanë qenë shumë të mëdha por, falë përgatitjes profesionale të ekipeve të FSK-së dhe falë vullnetit të madh, për të mos lejuar të ndodhë ndonjë katastrofë natyrore për vizitorët në këto pjesë, është arritur që operacioni i ekipeve të çminimit të kryhet me sukses.

Hoxhaj: Qeveria do të vazhdojë të investojë nëzhvillimin e Komunës së Drenasit

Drenas, 6 shkurt (ER) - Zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj të mërkurën ka qëndruar në Komunën e Drenasit, ku së bashku me kryetarin e kësaj komune, Ramiz Lladrovci, kanë vizituar kompani në parkun e biznesit në Drenas, fabrikën për përpunimin e plastikës "Powerpack LLC", fabrikën për përpunimin e barnave "Genti Pharm", fabrikën për prodhimin e ashensorëve në partneritet me një kompani gjermane "Lift Kosova". Hoxha ka thënë se ishte i mahnitur nga standardet e larta që i përdorin këto kompani për nxjerrjen e produkteve të tyre në tregun vendor. "Shumë prej këtyre kompanive tashmë kanë nisur të eksportojnë në vende të ndryshme të rajonit dhe të Evropës", ka thënë Hoxhaj. Zëvendëskryeministri Hoxhaj ka vizituar edhe Shkollën e Mesme Teknike "Fehmi Lladrovci", me ç'rast ka theksuar se rritja e pagave që është bërë me ligjin e ri, i cili u miratua javën e kaluar, është edhe përgjegjësi e re për rritjen e cilësisë në mësimdhënie. "Qeveria qendrore do të vazhdojë të investojë në zhvillimin e Komunës së Drenasit", ka thënë Hoxhaj.

Trepça dhe studentët, sfidat politike dhe shoqërore ndër vite dhe perspektiva për të ardhmen

Shkruan: Ferat SHALA

Tash këtyre ditëve dhe muajve të fundit me intensitet të shtuar po na bëhet problematikë dhe temë ditore rasti "Trepça". Kjo temë mua dhe brezin tim natyrshëm na kthen në një kohë krejt tjetër, në kohën kur ishim të rinj. Në kohën kur ishim studentë dhe, kur para më shumë se tri dekadave, studionim në Fakultetin Xehetar - Metalurgjik në Mitrovicë. Edhe para tri dekadash ishte po kjo temë dhe shtroheshin po këto dilema, por në një kontekst dhe aktorë të tjerë. Atëherë ne nuk kishim shtet, por kishim rininë dhe studentët me vete. Pra, ishin një trup i përbashkët, studentët dhe minatorët.

Kreatura Jugosllavi kishte filluar të kalbej. Ndryshimet politike dhe shoqërore në Evropën Juglindore po lëviznin me shpejtësi, garda e vjetër e politikanëve të Kosovës dhe politika e tyre pothuajse ishin në përfundim. Një pjesë e politikës së asaj kohe hamendeshin para këtij rreshtimi, me ne apo me ata?

Një pjesë e kësaj politike u rreshtuan me ne pasi ishin harxhuar dhe nuk i duheshin askujt më, ndërsa një pjesë tjetër filloi po braktisej vetvetiu nga pushteti serbo-jugosllav. Trepça ishte mundësi, moment, ishte rasti dhe qëllimi që intelektualët, populli, studentët dhe minatorët t'i thonë jo politikës anti-shqiptare dhe anti-Kosovë. Ndoshta si asnjëherë tjetër me greva e protesta dhe me gjithë format e kundërshtimit.

Atëherë, minatorët të futur në grevë, brenda minierave anekënd Kosovës dhe studentët, po ashtu në greve në mensë, amfiteatër dhe objekte të tjera universitare, po e kundërshtonim suprimimin e autonomisë së Kosovës, po kundërshtonim eksploatimin e Trepçës dhe anekënd vendit po kundërshtonim një pushtim të egër që i bëhej Kosovës.

Grupi i studentëve të xehetaro-metalurgjisë që ishin pjesë aktive e zhvillimeve të kohës

Sot, pas një dekade të shtetformimit, përsëri na shfaqet në top agjendë "Trepça", lufta për Trepçën dhe qëndrimet e niveleve të ndryshme ndërkombëtare për të. Fatkeqësisht, as atëherë e as sot nuk jemi unikë për të njëjtën temë. Përkundër këtij dallimi, sot përparësitë janë në anën tonë, në anën e së drejtës, në anën e shumicës, në anën e atyre që sakrifikuan shumë për Trepçën dhe me Trepçën.

Trepça në këto momente ka një bazë të mirë kushtetuese juridike si asnjëherë tjetër në historinë shekullore, por nuk mjafton vetëm kjo. Tani institucionet dhe Trepça duhet të punojnë në dy fronte. Në frontin e kujdesjes, mbrojtjes dhe avancimit juridik të Trepçës. Fronti i dytë ristrukturimi i thellë i gjitha resurseve humane, ristrukturim i thellë i metodave dhe praktikave eksploatuse, rivitalizim dhe investim kapital në pajisjet nxjerrëse dhe përpunuese.

Trepça e re, Trepça jonë, domosdoshmërisht duhet të rrugëtojë me një koncept të ri, me mentalitet dhe kulturë të re, drejt ekonomisë së tregut te lirë. Tani si shoqëri aksionare, punëtorët dhe qeveria janë partnerë, kanë të ndarë edhe interesat dhe kjo praktikë ekonomike kërkon bashkërendim të hapave operacionalë investues me kapital të brendshëm apo të jashtëm. Ky proces i rivitalizimit duhet të përcillet me transparencën maksimale dhe pa politikë ditore. Vetëm kështu "Trepça" e re mund të kthehet në ndërmarrje likuide, mund të kthehet në tregun e brendshëm dhe tregun e jashtëm.

Nëse para tri dekadash kërkohej mund, sakrificë deri në vetëflijim, kërkohej të protestonim e të demonstronim, kërkohej të burgoseshin e të vriteshin, studentë e minatorë, sot e kemi obligim të unifikohemi dhe organizohemi për të derdhur djersë.

Çdo vonesë për fillimin e rivializimit të "Trepçës" ka çmim të lartë, andaj përgjegjësitë për këtë janë obligim moral, institucional dhe kushtetues ndaj Kosovës. Në këtë shkrim me shkas nuk kam se si mos t'i kujtoj gjeneratat e minatorëve duarartë, por kësaj radhe me theks të veçantë do t'i kujtojë ish-kolegët studentë të Fakultetit Xehetaro-Metalurgjik, që ishin shumë aktivë në greva, protesta e demonstrata, duke dhënë edhe jetën në ballë të demonstratave, siç ishte rasti me studentin Selman Vojvoda, tani dëshmor, i vrarë në demonstrata në Mitrovicë.

Takim në mensën e studentëve: Bajram Sylejmani (dëshmor i kombit), Ragip Thaqi, Ramadan Bresilla dhe Ferat Shala

Sindikata e "Trepçës" paralajmëron protesta para Zyrës së BE-së në Prishtinë

MITROVICË, 6 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka pritur të mërkurën në takim kryetarin e Sindikatës së Pavarur të "Trepçës", Shyqyri Sadiku, me të cilin ka diskutuar rreth deklarimit të zëdhënëses së BE-së, Maja Kocijançiq, e cila ka thënë se çështja e "Trepçës" duhet të zgjidhet nëpërmjet marrëveshjes gjithëpërfshirëse për normalizimin e dialogut ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit në Bruksel, edhe përkundër faktit se Kuvendi i Republikës së Kosovës para pak ditësh ka votuar Statutin e ri për "Trepçën".

Bahtiri dhe Sadiku kanë kundërshtuar fuqishëm deklaratën e zëdhënëses së BE-së, duke thënë se tema mbi "Trepçën" nuk guxon të jetë asnjëherë pjesë e diskutimeve në Bruksel sepse, sipas tyre, "Trepça" është e minatorëve dhe përbën një pasuri kombëtare. Ata kanë thënë se diskutimi për "Trepçën" cenon drejtpërdrejt sovranitetin e Republikës së Kosovës. Të dyja palët kanë qenë të pajtimit që zëdhënësja e BE-së, Maja Kocijançiq, t'i tërheqë qëndrimet e saj për çështjen e Trepçës përmes një deklarate, përndryshe Sindikata e Pavarur e "Trepçës" shumë shpejt do të organizojnë protesta para zyrave të BE-së në Prishtinë.

BE-ja nuk do të rihapë marrëveshjen për Brexitin

Bruksel, 6 shkurt - Presidenti i Këshillit Evropian, Dolad Tusk shpreson se kryeministrja britanike, Theresa May do të shkojë sot (e enjte) në Bruksel me "sugjerime realiste" për mënyrën se si të gjendet një rrugëdalje nga bllokada rreth Brexitit.
Tusku tha se BE-ja nuk do të rihapë marrëveshjen tashmë të dakorduar të daljes së Britanisë së Madhe nga Bashkimi Evropian.
Presidenti Tusk, në një konferencë të përbashkët për media me kryeministrin irlandez, Leo Varadkar, përsëriti qëndrimin e Bashkimit Evropian, që masa mbrojtëse në kufirin irlandez duhet të mbetet.
"Po pyesja se si duket një vend i caktuar në ferr, për ata që e promovuan Brexitin, pa pasur më parë ndonjë plan për mënyrën se si ta bënin atë në mënyrë të sigurt", tha Tusku.
Ndërkaq kryeministri irlandez tha se marrëveshja Brexit, të cilën e hodhi poshtë Parlamenti britanik ka qenë "më e mira e mundshme".

Trumpi zotohet për ndërtim të murit, konfirmon samitin e dytë me Kimin

Presidenti i amerikan, Donald Trump në fjalimin e tij të martën drejtuar kombit, është zotuar edhe një herë se do të ndërtojë murin me Meksikën dhe ka konfirmuar se do të mbajë një samit të dytë me liderin e Koresë Veriore, Kim Jong un gjatë këtij muaji në Vietnam

UASHINGTON, 6 SHKURT - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump ka shfrytëzuar të martën fjalimin e tij drejtuar kombit, për t'u zotuar edhe një herë se do të ndërtojë murin me Meksikën.
Kjo temë është kthyer në çështje të ndarjes së thellë partiake në SHBA, derisa Trumpi ka thënë edhe se "hetimet qesharake" të demokratëve mund të dëmtojnë prosperitetin amerikan.
Ai ka mbajtur fjalimin në Dhomën e Përfaqësuesve në Kongres, ndonëse është duke u përballur me mospajtime politike rreth kërkesave të tij për të ndërtuar murin, i cili ka thënë të jetë shumë i nevojshëm për të ndalur imigrimin ilegal dhe kontrabandimin e drogës.
Ai e ka cilësuar imigrimin ilegal si "krizë kombëtare urgjente", mirëpo nuk është ndalur shumë tek ideja për shpalljen e gjendjes emergjente, e cila do t'i lejonte atij të siguronte paratë për murin pa miratimin e Kongresit.
Në vend të saj, presidenti amerikan u ka bërë thirrje demokratëve dhe republikanëve që të gjejnë një kompromis deri më 15 shkurt.
"Në të kaluarën, shumica e njerëzve në këtë dhomë kanë votuar për murin, mirëpo muri i duhur nuk është ndërtuar asnjëherë. Do të ndërtohet", ka thënë Trumpi para Kongresit.
Për demokratët, një ide e tillë konsiderohet e paefektshme dhe humbje e të hollave.
Ndërkohë Trumpi ka paralajmëruar demokratët për përpjekjet e tyre që të hetojnë administratën e tij, si dhe ka përmendur përfshirjen e SHBA-së në luftëra të huaja, çka sipas tij mund të dëmtojë ekonominë amerikane.
"Një mrekulli ekonomike është duke ndodhur në Shtetet e Bashkuara dhe gjërat e vetme që mund ta ndalin atë janë përfshirja në luftëra të kota, politika, apo hetime partiake qesharake", është shprehur ai.
Deklaratat e tij kanë ardhur pas demokratët, që tani kontrollojnë Dhomën e Përfaqësuesve kanë planifikuar të zhvillojnë një seri të hetimeve ndaj administratës së Trumpit, teksa edhe këshilltari special, Robert Mueller heton ndërhyrjen e mundshme të Rusisë në zgjedhjet presidenciale të vitit 2016 në ShBA, si dhe ndonjë bashkëpunim të mundshëm të mes të këtij shteti me fushatën e Trumpit.
Rusia mohon vazhdimisht këto pretendime dhe ka thënë se nuk ka pasur asnjë bashkëpunim.

Pelosi e shqetësuar

Kryesuesja e Dhomës së Përfaqësuesve, Nancy Pelosi, e cila ishte veshur në të bardha, bashkë me shumë gra tjera, për të festuar përvjetorin e 100-të, prej kur gratë amerikane kanë fituar të drejtën për të votuar, ka duartrokitur me shqetësim disa herë, si dhe është parë e pakënaqur gjatë adresimit të Trumpit.
Ajo nuk ka treguar asnjë shenjë për bashkëpunim me Trumpin sa i përket çështjes së ndërtimit të murit.
Megjithatë presidenti amerikan ka shfrytëzuar fjalimin e tyre për të ofruar një dozë të kompromisit në çështjet e uljes së çmimit të ilaçeve, ndërtimit të rrugëve, urave dhe pjesës tjetër të infrastrukturës.
Adresimi tij televiziv ka qenë mundësia më e mirë për të treguar se është i nevojshëm ndërtimi i murit. Fjalimi është mbajtur me një javë vonesë për shkak të mbylljes së Qeverisë, e cila ka përfunduar më 25 janar.
"Po e them thjeshtë, muret funksionojnë dhe muret shpëtojnë jetë. Prandaj, le të punojmë së bashku, të bëjmë kompromis dhe të arrijmë një marrëveshje që do të sigurojë Amerikën", është shprehur Trumpi.

Moment i rrallë i unitetit

Pavarësisht thirrjeve të presidentit për bashkim, demokratët kanë qenë të ftohtë pothuajse gjatë gjithë takimit.
Mirëpo kur presidenti ka folur për fuqinë e kombit amerikan, anëtarët e partisë së tij kanë nisur të brohorasin dhe të thërrasin "ShBA!"
Demokratët kanë qëndruar të ulur nëpër karriget e tyre, derisa disponimi ka ndryshuar papritur kur presidenti ka përmendur numrin rekord të grave të Kongres, me ç'rast të gjithë u janë bashkuar thirrjeve "ShBA".
Momente të tilla janë të rralla në këtë legjislaturë, derisa Trumpi ka qenë në mes të gjithë kësaj situate.

Trumpi dhe politika e jashtme

Presidenti amerikan ka konfirmuar në këtë takim se do të mbajë një samit të dytë me liderin e Koresë Veriore, Kim Jong un më 27-28 të këtij muaji në Vietnam.
"Pengjet tona janë kthyer në shtëpi, testimet bërthamore janë ndalur dhe nuk ka pasur asnjë nisje të raketave në 15 muaj. Nëse nuk do të isha president i SHBA-së, unë mendoj se tani ne do të ishim në një luftë të madhe me Korenë Veriore", tha ai.
"Ende ka shumë punë për të bërë, mirëpo marrëdhënia ime me Kim Jong-un është e mirë", tha Trumpi.
Ai ka bërë thirrje për vëmendje në përpjekjet e tij për t'i rishkruar marrëveshjet tregtare me Kinën dhe kombet tjera, ashtu që të krijojë situatë më të favorshme për ShBA-në.
Teksa këshilltarët e tij ekonomikë janë duke punuar në hartimin e paktit me Kinën, Trumpi ka thënë se marrëveshja duhet të përfshijë ndryshim të vërtetë dhe t'iu japë fund praktikave të padrejta tregtare, të ulë deficitin kombëtar dhe të ruajë vendet e punës në ShBA.
Ai ka përmendur edhe kërcënimet e Iranit kundër Izraelit.
"Ne nuk do t'i largojmë sytë nga regjimi që brohorit, vdekje Amerikës dhe kërcënon me gjenocid kundër hebrenjve", ka deklaruar Trumpi.

Papa: Murgeshat janë përdorur si skllave seksi nga klerikët

ABU DABI, 6 SHKURT - Papa Françesku pranoi se klerikët i kanë abuzuar seksualisht murgeshat dhe se, në një rast, ato janë mbajtur si skllave seksi.
Ai tha se në atë rast, paraardhësi i tij, Papa Benedikti, është detyruar të mbyllë një kongregacion të tërë të murgeshave që janë abuzuar nga priftërinjtë.
Kjo besohet se është hera e parë që Papa Françesku ka pranuar abuzimin seksual të murgeshave nga kleri.
Ai tha se Kisha Katolike ka bërë përpjekje ta adresojë problemin, por shtoi se ai po vazhdon ende.
Duke folur për gazetarët gjatë një turneu historik në Lindjen e Mesme, Papa tha se Kisha ka një problem, rrënjët e të cilit qëndrojnë te vlerësimi i grave "si klasë e dytë".

ME ALI AHMETIN MAQEDONIA NË NATO

Maqedonia nën udhëheqjen e Ali Ahmetit shkelë të pashkelurën deri më tani në historinë e saj!

Ismet SYLEJMANI

Politikani modern shqiptar, patrioti e atdhetari i lavdishëm, luftëtari e komandanti i përgjithshëm i UÇK-së, udhëheqësi i popullit shqiptar Ali Ahmeti, jo vetëm është njëri prej dirigjentëve fantastik dhe kyq të funksionimit të Maqedonisë si maqedono-shqiptare, por është edhe njeri prej aktorëve e faktorëve më të mëdhenj të stabilitetit e paqes, në rajon dhe më gjerë!

Ali Ahmeti, ky shqiptar i madh e i lavdishëm, që me politikën e tij të madhe dhe të hapur euroatlantike, ka dëshmuar dhe po dëshmon se është aleat i madh i paqes dhe stabilitetit jo vetëm në Maqedoni, në Ballkan dhe Europe por edhe më gjerë, me politiken e tij kombëtare në Maqedoni, po dëshmon se populli shqiptar ka rrol vendimtarë e të padiskutueshëm në funksionimin normal, progresiv e demokratik të Maqedonisë brenda dhe jashtë sajë!

Maqedonia që pas lindjes së sajë, me Ali Ahmetin në udhëheqje, për herë të parë ka marrë pamjen e saj reale dhe të vërtetë, sepse duke e pasur popullin shqiptar njërin prej themeluesve të saj, ajo hyn në NATO dhe në BE!

Populli shqiptar në Maqedoni nën udhëheqjen e birit dhe udhëheqësit të saj Ali Ahmeti, duke hyrë në NATO dhe BE, jo vetëm përmbushë kërkesën e madhe dhe largëpamëse për brezat shqiptare që do të vijnë, por dëshmon edhe njëherë përpara botës, se ishte i shtypur padrejtësisht në ish-Maqedoninë jugosllave, se është popull i madh dhe heroik, pasi mposhti të gjitha të kqiat që i ranë mbi supe, dhe tash fitimtarë si kurrë më parë, radhitet përkrah popujve që janë zot të fateve të veta në shtetet e tyre!

Maqedonia në NATO dhe në BE është fitore e madhe jo vetem e udhëheqësit të popullit shqiptar Ali Ahmeti, por edhe të gjitha atyre figurave dhe personaliteteve të mëdha shqiptare në këtë shtet, të cilat me vite dhe dekada, bënë që populli shqiptar ta ruajë fuqinë e tij përballë politikës shfarosëse dhe zhdukëse të xhelatit e kriminelit Rankoviq dhe pasardhësit të tij, kryexhelatit të Ballkanit Milosheviq!

Maqedonia në NATO dhe BE nderon popullin shqiptar, nderon gjakun e derdhur për liri, nderon të plagosurit e lirisë, nderon luftëtaret dhe komandantët e UÇK-së, nderon flamurin,nderon barazinë gjuhësore, nderon dy universitetet shqiptare, nderon policinë shqiptare, nderon ushtrinë shqiptare dhe nderon administratën shqiptare!

Maqedonia në NATO dhe BE, është nderim për aleatet e mëdhenj të popullit shqiptar SHBA, Angli, Gjermani, Itali, France dhe të tjerë!

Maqedonia në NATO dhe BE, është eveniment kundër errësirës dhe vuajtjeve të popullit shqiptar jo vetëm në Maqedoni dhe më gjerë!

Maqedonia në NATO dhe BE, për popullin shqiptar është fitore e madhe dhe përspektivë e sigurtë me të ardhme e cila garanton paqe dhe stabilitet në të gjitha fushat!

Maqedonia në NATO dhe BE është fitore e madhe për popullin shqiptar dhe udhëheqësin e saj Ali Ahmeti!

Maqedonia në këto dy institucione të mëdha kontinentale dhe botërore, është fitore epokale shqiptare!

Hyrja e Maqedonisë në NATO dhe BE, vetëm të mira dhe vetëm përspektivë i sjell popullit shqiptar, i cili ka vuajtur shumë në të kaluarën nga pushtues dhe rregjime të ndryshme!

Prishtinë, më 6 shkurt 2019!

E rrallë

'Kopshti i mrekullive' në Dubai

Është një nga pikat turistike më të bukura në Dubai. "Kopshti i mrekullive" në Lindjen e Mesme është pjesë e Librit të Rekordeve Gines. Pa dyshim se është një destinacion unik ku lulëzojmë mbi 100 milionë lule. "Kopshti i Mrekullive" është një vend i njohur për banorët dhe turistët që e vizitojnë për t'i shijuar varietetet e luleve.

FOTO E DITES

Disa skiatorë shihen në një ditë me diell pranë Zell am See në Austri. /AP/

E jashtëzakonshme

Zbulohet merimanga më e madhe helmuese në botë

Një lloj i merimangës helmuese është zbuluar në Afrikën e Jugut. Ekspertët thonë se kjo mund të jetë më e madhja e familjes vdekjeprurëse arachnide. Pickimi i saj lëshon helm dhe viktimat mund të përfundojnë në spital. E quajtur me emrin "Button Phinda", merimanga e re mendohet të jeta e para e kësaj specieje e zbuluar në 27 vjet.

BARSOLETA E DITËS

Gjatë shërbimit ushtarak Fadilit i vdes babai por, duke ditur sa shumë të lidhur ishin, komandanti zgjedh një metodë tjetër për t'ia thënë:
- Ushtarë, kush ka baba, një hap para!
Fadili me shumicën e ushtarëve e bëjnë një hap para.
Komandanti:
- Fadil, ku po shkon?! Kthehu në rresht!

Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney

Në ora 17:30

"THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston

Në ora 19:30

"MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Raftery, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers

Në ora 22:00

"HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

DASHI
Mëngjesi i kësaj dite ju ka gjetur mjaft energjik. Do të shpërndani pozitivitet me këdo që do t'ju lidhë puna sot.

DEMI
Të papriturat gjithmonë ju kanë shkaktuar panik. Edhe pse nuk i keni gjërat nën kontroll, nuk duhet të jeni të shqetësuar për këtë fakt.

BINJAKËT
Edhe pse ju ka kapur paniku lidhur me një çështje të caktuar është mirë të mos e shfaqni. Tregohuni të qetë dhe do ta keni situatën në kontroll.

GAFORRJA
Përvoja do t'ju vijë në ndihmë sot të dilni nga një ngërç i papritur. Nëse nuk do të ishit mësuar me këto situata mund ta pësonit.

LUANI
Nga ana sentimentale keni mjaft dyshime në lidhje me raportin tuaj. Duhet t'i qartësoni sepse kështu do të vuani veç ju.

VIRGJËRESHA
Keni filluar të hapeni me të tjerët dhe të krijoni njohje të reja. Keni kuptuar që qëndrimi vetëm ju bën keq shpirtërisht.

PESHORJA
Sot do të zgjoheni me humor të mirë që në mëngjes. Partneri është shumë i pranishëm në ditën tuaj dhe nuk do t'ju cenojë asnjë fjalë.

AKREPI
Gjërat dhe situatat që nuk ju pëlqejnë sot mjafton t'i hidhni pas krahëve. Nëse familja ka nevojë për ju, sot duhet t'i përgjigjeni menjëherë.

SHIGJETARI
Sot do të ndiheni në paqe me veten dhe ambientin që ju rrethon. Gjithçka po shkon siç e kishit parashikuar dhe mbrëmja do t'ju gjejë të çlodhur.

BRICJAPI
E keni humbur ndjesinë e të qenit të përkëdhelur dhe për këtë gjë do ta ndieni shumë mungesën sot. Ndiheni të mposhtur nga vetmia.



UJORI
Gjithçka që i takon punës suaj duhet ta zërë vetëm orarin e caktuar. Mos e ngarkoni ditën me gjëra që janë komplet sekondare për ju.

PESHQIT
Sot do t'ju kontaktojë një person që në të shkuarën ju ka ndihmuar me punë dhe çështje financiare. Jeni drejt një bashkëpunimi të ri.

Gigi Hadid sjell linjën e veshjeve në bashkëpunim me "Reebok"



Supermodeluesja Gigi Hadid ka dizajnuar një koleksion rrobash sportive me "Reebok". Dhe ju pa dyshim se do të mahniteni nga krijimtaria e saj. Ylli i pasarelave ka prezantuar dy nga dizajnet e para, një kostum sportiv me ngjyrë të zezë dhe të verdhë, si edhe një me ngjyrë të bardhë e portokalli.

Fejohet Jennifer Lawrence

Jennifer Lawrence është fejuar me drejtorin e Galerisë së Arteve, Cooke Maroney. Lajmin e ka konfirmuar përfaqësuesi i saj për "JustJared". Aktorja 28-vjeçare, fituese e çmimit Oskar, nxiti thashetheme për fejesë këtë javë pasi u pa me një unazë gjigante derisa po darkonte me Cooke. Ata nisën lidhjen në pranverën e vitit 2018 dhe janë parë shumë shpesh së bashku.

Bebe Rexha tani edhe në film të animuar

Këngëtarja me origjinë shqiptare do të jetë dublante e një prej personazheve në film, së bashku me Kelly Clarkson, Nick Jonas, Wanda Sykes, Gabriel Iglesias, Pitbull, Wang Leehom, Blake Shelton, Janelle Monae, Emma Roberts, Charli XCX dhe Lizzo. "Ky film ka një mesazh kaq të bukur dhe unë mezi po pres që ju të gjitha ta shihni", ka shkruar në rrjetet sociale Bebe Rexha.



Reperi i njohur kalon me sukses operacionin për transplantim të veshkës

Reperi nga Filadelfia, Freeway, i cili luftoi për vite me sëmundje të veshkave, më në fund ka bërë transplantim. 40-vjeçari ka postuar një video në "Instagram" duke njoftuar se procedura ka shkuar me sukses. "Faleminderit për lutjet dhe mbështetjen tuaj. Gjithçka shkoi mirë, operacioni shkoi mirë. Unë jam duke u shëruar", ka thënë Freeway.

Udhëtim në Holandë, mes ekspozitave të mëdha dhe muraleve

Rembrandt dhe Van Gogh, parqe natyrore. Dhe 110 restorante absolutisht të mira

Në vitin 2019, 350 vite kanë kaluar që nga vdekja e Rembrandt van Rijn. Puna e mjeshtrit të madh dhe periudhës së pasurisë së madhe dhe përparimit në të cilën jetonte Holanda, e ashtuquajtura Epoka e Artë, përkujtohen gjatë vitit 2019, me ngjarje të vërtetë të jashtëzakonshme në fushën kulturore. Por, jo vetëm… Si pjesë e festimeve të dedikuara për Rembrandt, në fakt, ekspozita të veçanta janë planifikuar në të gjithë Holandën. Një mundësi për të vizituar qytetet e bukura historike të Holandës, nga Amsterdami në Utrecht.

Një park i ri natyror - Holanda ka një park të ri kombëtar: është Parku Kombëtar i 'Nieuw Land', që ndodhet në qendër të vendit, midis IJsselmeer dhe Markeermeer, ish Zuiderzee, në krahinën e Flevoland. Tipari dallues i Nieuw Land, i zgjeruar për rreth 29,000 hektarë, është se ajo u krijua nga reklamimi i tokave të shqyer nga deti. Në vitin 1940 kjo zonë ishte në fakt e tharë për të mbrojtur rajonin nga përmbytjet dhe stuhitë e detit. Sot turistët mund të zbulojnë natyrën dhe të bëjnë shëtitje ku në të kaluarën ka pasur vetëm ujë të kripur.

Van Gogh, portretet - Ekspozita "Rrethi i brendshëm i Van Gogut: miq, familje dhe modele" që do të hapet në shtator në Den Bosch do të zbulojë aspekte të panjohura të artistit të torturuar dhe të vetmuar, falë njerëzve që luajtën rolet kyçe në veprimtarinë e tij artistike dhe private , si gjatë qëndrimit në Brabant dhe në jug të Francës. Vizitorët do të kenë mundësinë të njihen me Vincent Van Gogh përmes dokumenteve konfidenciale dhe personale: letrat që ai shkroi, skicat që do të kishin krijuar vepra të pavdekshme, portrete dhe vizatime të dedikuara për rrethin më të ngushtë të miqësive të tij.

Muralet e Utrehtit - Qyteti i Utrehtit është plot me murale fantastike dhe mbishkrime. Përveç imazheve të vetme, forma të reja të artit gjithnjë e më shumë po përjetohen në muret e qytetit, nga poemat në fotografi. Çdo imazh tregon një histori dhe për të njohur historinë që qëndron prapa këtyre punimeve metropolitane, është krijuar një "Tour Street Tour" i organizuar nga "Përshëndetje nga Utrehti". Është një rrugë në këmbë në qendër: ajo mbahet çdo të diel në orën 11 të mëngjesit duke filluar nga sheshi Neude.

Restorantet më të mira - Michelin paraqet botimin e vitit 2019 të guidës së famshme të kuqe kushtuar Holandës, duke demonstruar edhe një herë potencialin eno-gastronomik të vendit. Kuzhina e famshme dhe talentet e reja plotësojnë plotësisht pritjet e gourmets. Me dy restorante të reja me dy yje dhe dymbëdhjetë yje të rinj, botimi i vitit 2019 i Udhëzuesit të Michelin-it i jep Holandës një total prej 110 restorantesh me yje. Me dy restorante të reja me dy yje dhe dymbëdhjetë yje të rinj, botimi i vitit 2019 i Udhëzuesit të Michelin-it i jep Holandës një total prej 110 restorantesh me yje.

Fshati i djathit - Në Gouda kinemaja e vjetër Arcade do të shndërrohet në një fshat të djathit të quajtur Përvoja e djathit, sepse shumë e njohin djathin Gouda, por pak e njohin historinë e saj. Përvoja e djathit, hapja e së cilës është caktuar për pranverën e vitit 2019, do të bëhet një tërheqje e re për vizitorët në Gouda. */Gazeta Shqip*

Të fshehtat e gruas së Henri Matisse

Amelie mbante flokët e gjata të zeza që i binin nën qafë, dhe në vështrim dukej sikur fshihte gjithnjë diçka. Ky portret nuk mund të mos binte në sy të djaloshit që ishte ulur pranë saj, veshur me një kostum elegant, teksa ndodheshin të dy në një dasmë, në Parisin e vitit 1897. Henri Matisse do ti fliste menjëherë vajzës, duke e ftuar në vallëzim.

Në mbrëmje ai do të këmbëngulte për ta shoqëruar në shtëpi, dhe kaq do të mjaftonte për ta bërë atë të mos flinte e qetë atë mbrëmje. Për gati një vit, Henri dhe Amelie Matisse do të jetonin një histori dashurie, që do ta frymëzonte shumë piktorin e ri. Ai do të gjente tek ajo gjithë ngjyrat e një stine për të cilat kishte aq shumë nevojë. Më 1898 ata do të martoheshin, duke u shpërngulur në një apartament të vogël. Amelie do të hapte një dyqan këpucësh, ndërsa Henri do të vijonte punën në studio.

Shumë shpejt gruaja e kuptoi se nuk do të ishte asnjëherë e para në jetën e Matisse. Teksa shihte talentin e tij ajo e dinte se një ditë do ta humbte nëse nuk do ta linte në lirë. Ai duhet të kishte gjithë hapësirën e duhur për të eksperimentuar e për tu ndjerë i vlerësuar, dhe ajo do të ishte gjithnjë e dyta pas artit të tij. Amelie e pranoi këtë fakt duke punuar që t'ia bënte më të lehtë rrugën drejt suksesit. Pas lindjes së dy djemve, ajo do të vijonte të bënte rolin e menaxheres së pikturave të tij. Por më vonë marrëdhënia e tyre do të niste të kishte probleme për shkak të presionit që Matisse ndjente nga prania e saj.

Ai nisi të kërkonte më shumë liri. Raporti i tyre do të ndjehej i kërcënuar në kohën kur Matisse nisi një histori dashurie me modelen e një pjese të madhe të veprave të tij Lidia Delectorskaya. Dhe pse për një kohë të gjatë Amelie e la të jetonte këtë lidhje, duke menduar se kjo do ta ndihmonte në artin e tij, në fund ajo i kërkon të

zgjedh mes të dyjave. Artisti zgjedh gruan, por do të ndjente gjithnjë mungesën e së dashurës. Me një jetë të trazuar, Amelie Matisse kujtohet sot, si gruaja që qëndron pas çdo ngjyre që krijoi artisti. Biografët vijojnë të gërmojnë për jetën e saj, për ti dhënë kuptim shumë pikëpyetjeve mbi siluetat femërore në veprën e Matisse. */Gazeta Shqip*

Harrojeni "dimrin e zi", këto 4 ngjyra do t'ia u bëjnë stinën perfekte

Shpesh stinën e dimrit, kur përzgjedhim veshjet e lidhim me tonet e ftohta, ku dominon ngjyra gri dhe ajo e zezë, por ekspertët e fushës së modës, kërkojnë që t'i dëgjoni dhe kësisoj t'i shtoni më shumë ngjyrë veshjes tuaj.

Sipas tyre janë disa nuanca të mrekullueshme, shumë të ngrohta që padyshim janë ideale që t'i bartni në ditët e ftohta, por që nuk janë të detyrueshme për t'i pasur në garderobën tuaj. Ndër të parat që kanë eksperimentuar me këto ngjyra janë Bella Hadid nga femrat, dhe ish-ylli i Real Madrid, David Beckham nga gjinia e kundërt.

Ngjyra e verës

Kjo ngjyrë garanton dukje luksoze, e cila gjithmonë është e mirë për përditshmërinë gjatë dimrit. Kjo ngjyrë njëkohësisht është edhe e ngrohtë edhe dramatike, por edhe joshëse.

Sipas stilistëve është e thjeshtë për t'u kombinuar, sepse shkon me shumicën e nuancave të tjera, ndaj do të keni më shumë mundësi për kreativitet.

Ngjyra e hirtë

Është kryesorja në listë, apasi përdoret gjatë të gjitha stinëve të vitit, aq më shumë në ditët e dimrit. Është neutrale dhe klasike, ndërkaq nuancat e shndritshme do t'ju freskojnë dhe shkojnë mirë me gjithë paletën e ngjyrave.

Ngjyra e gjelbër

Nëse doni trikon me ngjyrën e bukur të gjelbër që nuk përdoret vetëm që t'i kthejë sytë nga ju dhe t'i japë freski fytyrës suaj, atëherë zgjidhni edhe këpucët në nuancë të ngjashme, pasi do të keni edhe kombinim të përsosur!

Ngjyra e mustardës

Është e shkëlqyeshme për freskim të veshjeve njëngjyrëshe, posaçërisht në ditët e ftohta. Për shkak të nuancës specifike që ka, ditëve të dimrit ju jep një frymë vjeshte.

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	LAZIO - EMPOLI	1	REAL BETIS - VALENCIA	GG	AL HUSSEIN V AL BAQAA	1

Gashi: Jam lojtar i lirë, nuk u ofrohem klubeve

Afati i janarit ka përfunduar dhe Egzon Gashi vazhdon të jetë lojtar i lirë. Ai për gazetë ka bërë me dije se arsyeja e mosangazhimit në ndonjë klub është fakti se ai nuk u vetofrohet klubeve. "Ende jam lojtar i lirë, pasi nuk më ka kontaktuar asnjë skuadër, në të njëjtën kohë nuk i jam vetofruar asnjë klubi. Personaliteti im nuk lejon t'u imponohem të tjerëve. Kjo është arsye pse nuk jam angazhuar në këtë kampionat", ka thënë Egzon Gashi

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 6 SHKURT - Sulmuesi i njohur Egzon Gashi, i cili ka fituar të gjithë titujt në futbollin e Kosovës me Besën e Pejës dhe Feronikelin nga Drenasi, vazhdon të jetë lojtar i lirë. Ai ende nuk është paraqitur në asnjë klub në këtë kampionat, kurse të mërkurën për "Epokën e re" e ka zbuluar arsyen që është pa skuadër. "Ende jam lojtar i lirë, pasi nuk më ka kontaktuar asnjë skuadër, në të njëjtën kohë nuk i jam vetofruar asnjë klubi. Personaliteti im nuk lejon që t'u imponohem të tjerëve. Kjo është arsyeja pse nuk jam angazhuar në këtë kampionat", ka thënë Gashi, i cili ka luajtur me sukses edhe për skuadrën e Vëllaznimit nga Gjakova.

Sulmuesi pejan që ka cilësi të mëdha në futboll ka mbetur i befasuar me klubet ku ka qenë pjesë, sepse asnjëherë nuk është respektuar për djersën dhe kontributin e madh që ka dhënë sa ishte pjesë e tyre. "Disa klube ku kam dhënë kontribut të madh nuk janë treguar korrekte ndaj meje, por edhe disa personave që iu kam gjendur në kohët më të vështira nuk po u bie ndërmend për mua. Thjesht, nuk jam person që e luti ndonjë kryesi të klubit", ka deklaruar ai.

I pyetur se a ka menduar të largohet nga futbolli aktiv, sikurse që kanë bërë edhe lojtarë të tjerë që ishin të dëshmuar në futbollin e Kosovës, Gashi është përgjigjur: "Jam ende i ri që të largohem nga futbolli. Besoj se shumë shpejt do të aktivizohem në ndonjë klub për faktin se kam ende shumë për t'i dhënë futbollit. Vazhdimisht jam stërvitur individualisht dhe forma ime është e mirë, ani pse përgatitja individuale dallon me përgatitjen në grup".

Egzon Gashi nuk e ka përjashtuar një rikthim të mundshëm në skuadrën e Besës, në të cilin edhe bëri emër në futbollin e Kosovës. "Jam i hapur për të gjitha klubet në Kosovë, përfshirë edhe Besën. Do të pranoj cilëndo ofertë serioze që më vjen", ka deklaruar Gashi, i cili ka luajtur edhe për skuadrën e Istogut.

SHKURT

Ademi dhe Molleri flasin për miqësoren e 21 marsit

Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, i cili ndodhet në Romë, për punimet e Kongresit të UEFA-s, ka takuar shumë homologë. Të mërkurën i pari i futbollit të Kosovës është takuar me presidentin e Federatës së Futbollit të Danimarkës, Jesper Moller. Gjatë këtij takimi të dy presidentët janë pajtuar për specifikat e ndeshjes miqësore që do të zhvillohet më 21 mars në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë, por edhe për rritje të bashkëpunimit në sfera të ndryshme ndërmjet dy federatave. Kryetari Ademi ka takuar edhe presidentin e Federatës së Futbollit të Qipros, George Koumas, me të cilin janë diskutuar format e bashkëpunimit ndërmjet dy federatave.

Albin Tahiri, i 45-ti në Botërorin e Suedisë

Skitari që po e përfaqëson Kosovën në Kampionatin Botëror në Are të Suedisë, e ka përfunduar garën e supersllallomit të madh dhe është radhitur në vendin e 45-të, nga 49 garues sa e përfunduan pistën. Skitari Tahiri, në garën ku pjesëmarrës ishin 70 garues, u lëshua për 1 minutë, 31 sekonda e 72 të qindtat dhe ishte afër tetë sekonda larg vendit të parë. Përfaqësuesi i Kosovës do të bëjë gara edhe në katër disiplina të tjera, në Sllallom, Sllallom të Madh, Kombinim Alpik dhe Lëshim.

Kryeziu: Zhegrova është i talentuar

Hekuran Kryeziu ka dhënë fjalë të mëdha për Edon Zhegrovën. Futbollisti i Zurichut thotë se përforcimi i ri i Baselit ka potencial të madh. Së fundmi, Zhegrova u largua nga Genku për t'u huazuar për 18 muaj te klubi i madh zviceran, i cili e ka opsionin e blerjes definitive. "Unë e njoh atë që një vit e gjysmë nga ekipi kombëtar dhe jam mjaft i nderuar që ai luan për Kosovën dhe që tash është në Basel", ka thënë Kryeziu. Sipas tij, për një futbollist që lind dhe rritet në Kosovë është mjaft e vështirë të depërtojë në futbollin evropian. "Vetëm talentet më të mëdhenj mund ta bëjnë këtë", ka shtuar Kryeziu, i cili më pas e ka përshkruar edhe lojën e Zhegrovës. "Ai është mjaft i talentuar, i shpejtë me topin, i shkathtë dhe driblues. Po ashtu, ka teknikë të fortë dhe një të majtë të fuqishme. Ai ka potencial të madh dhe mendoj se e ka një karakter mjaft të fortë", ka deklaruar mesfushori i Zurichut.

Ai nënvizon se fakti që në Basel luajnë edhe dy shqiptarë, Taulant Xhaka dhe Albian Ajeti, do ta ndihmojë Zhegrovën të ambientohet më lehtë në klubin helvetik. "Ata sigurisht se do t'ia bëjnë ambientimin më të lehtë dhe, po ashtu, do ta ndihmojnë në fushën e blertë", përfundoi Kryeziu.

Gjikokaj e lumtur që luan për Kosovën

PRISHTINË, 6 SHKURT - Një prej hendbollisteve kryesore në përfaqësuesen e Kosovës, Mirela Gjikokaj, në një intervistë për faqen e internetit "Hanballspiller" ka folur për përvojën e saj me Kosovën. Gjikokaj, e cila me prejardhje është nga Deçani, luan në pozitën e bekut të majtë dhe po ofron gjithnjë e më shumë për ekipin përfaqësues. "Jam kontaktuar nga Federata e Hendbollit të Kosovës në vitin 2016 dhe jam pyetur nëse jam e gatshme të luaj ndeshje ndërkombëtare për Kosovën. E kemi vlerësuar këtë si një mundësi të madhe për karrierën time. Deri më tash i kam luajtur 20 ndeshje ndërkombëtare me Kosovën dhe kemi fituar ndaj Gjeorgjisë dhe Izraelit në paraeliminatore për Kampionatin Evropian të vitit 2018. Jam më e reja në ekipin përfaqësues, ndërsa më ndihmon shumë fakti që te Kosova jemi së bashku me Dorentina Osmanin, që e kam bashkëlojtare edhe në klub. Po shikoj para për paraqitje dhe suksese të tjera me Kosovën", ka thënë Gjikokaj.

Shaqiri: Mbesim të parët deri në fund

LIVERPOOL, 6 SHKURT - Xherdan Shaqiri këmbëngul se presioni nuk ishte shkaku i barazimit të Liverpoolit kundër Leicester Cityt. Shqiptari ka pohuar se skuadra nuk po vuan dhe se lojtarët janë të relaksuar në këtë aspekt. "Unë nuk ndiej asnjë nervozizëm në ekip. Kjo skuadër dëshiron të fitojë çdo ndeshje. Unë nuk shoh asnjë presion këtu", ka thënë zvicerani për "Sky Sports". "Ne punojmë çdo ditë, ne shkojmë në çdo ndeshje me mentalitetin se do të qëndrojmë deri në fund të sezonit në vendin e parë. Ndoshta tifozët janë më nervozë se ne. Kjo është shumë normale. Kam përjetuar të njëjtën gjë në Bayern. Ne nuk bëhemi nervozë, vetëm luajmë lojën tonë dhe përpiqemi të fitojmë", ka deklaruar Shaqiri.

Skitarja Elba Kokaj ka synime të mëdha në Lojërat Olimpike Dimërore

PRISHTINË, 6 SHKURT - Elba Kokaj është një nga dy skitaret e vetme që do ta përfaqësojnë Kosovën në Lojërat Olimpike Dimërore Evropiane për të Rinj (EYOF) që mbahen prej 10-16 shkurtit në Sarajevë dhe Sarajevën Lindore të Bosnjë e Hercegovinës. Bashkë me Elbën, pjesëmarrëse në Sarajevë është edhe Klea Vrella. Elba është nga Prishtina dhe ka lindur më 5 tetor të vitit 2001, ndërsa që nga mosha 7-vjeçare ka filluar të merret me sportin e skitarisë. "Babai është arsyeja pse merrem me skitari. Më herët kam provuar të merrem edhe me basketboll, hendboll dhe volejboll, por më shumë më ka pëlqyer skitaria", ka thënë Kokaj për faqen zyrtare të Komitetit Olimpik të Kosovës.

Elba në Sarajevë do të garojë në disiplinat sllallom dhe sllallom të madh. Në të dyja këto disiplina ajo është nënkampione e Kosovës. Në muajt e fundit, falë mbështetjes financiare nga

Komiteti Olimpik i Kosovës, Elba dhe Klea janë përgatitur në Erzurum të Turqisë dhe në Brod të Dragashit, për t'i mbushur "bateritë" për paraqitje sa më mirë në EYOF Sarajeva 2019. "Kemi kaluar shumë mirë në përgatitje, kushtet ishin shumë të mira. Po ashtu, edhe në Brod ka pasur kushte të mira. Shpresoj të na ndihmojnë për rezultate sa më të mira", ka shtuar ajo. Edhe Elba si Klea ka garuar në gara të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, por EYOF Sarajeva 2019 është e veçantë për të. "Sigurisht se ka qenë ëndërr ta përfaqësojë Kosovën në një garë të tillë. Uroj të kem edhe rezultat të mirë", thekson skitarja e klubit të Prishtinës. Për Ekipin Olimpik të Kosovës, EYOF-i dimëror "Sarajeva 2019" do të jetë pjesëmarrja e dytë, pas debutimit në "Erzurum 2017".

Lakersat dhe LeBron turpërohen nga Indiana, triumfojnë Toronto e Oklahoma

INDIANAPOLIS, 6 SHKURT - Vijon sezoni me lëvizje i skuadrës së Lakersit, që pësoi zhgënjimin e radhës në NBA. Ekipi kalifornian u mund thellë 136-94 nga Indiana, ndeshje e dominuar nga kjo e fundit. Bogdanoviq me 24 pikë e Turner me 22 ishin shënuesit më të mirë, ndërkohë që diferencën e bënë lojtarët e stolit, nga ku erdhën 66 pikë. Rikthimi i LeBron Jamesit (18 pikë) nuk ndikoi te Lakersi, që bënë një ndeshje të dobët, i pambështetur si duhet nga skuadra. Fiton skuadra e Oklahomës, që mundi 132-122 Orlando, ndeshje e vendosur në periodën e fundit në favor të vendësve. Vazhdon momenti i mirë i Rajon Rondos,

REZULTATET

Charlotte - Clippers	115-117
Cleveland - Boston	96-103
Indiana - Lakers	136-94
New York - Detroit	92-105
Memphis - Minnesota	108-106
Oklahoma - Orlando	132-122
Philadelphia - Toronto	107-119
Portland - Miami	108-118

që realizoi 39 pikë, ndërsa Russell Westbrooku realizoi sërish një "triple double", me 16 pikë, 15 rebounde e 16 asiste. Skuadra e Torontos mposhti 119-107 Philadelphian jashtë fushës, duke ruajtur pozitat në krye të renditjes në Lindje. Leonard realizoi 24 pikë, mbështetur edhe nga Ibaka e Lowry, me nga 20 pikë secili, raporton "Telesport". Në takimet e tjera, ekipi i Clippers fitoi në sekondat e fundit 117-115 ndaj Charlottes jashtë fushës, ndeshje ku dyshja Harris-Williams realizoi 65 pikë së bashku. E njëjta situatë edhe në fitoren 108-106 të Memphisit ndaj Minnesota, me vendësit që triumfuan falë 25 pikëve të Conleyt dhe 23 të Jacksonit. Ekipi i Miamit, falë 28 pikëve të Whitesides, mposhti 118-108 Portlandin, ndërsa triumfoi 105-92 ndaj New Yorkut, sfidë ku u dallua Griffini me 29 pikë.

SHKURT

Schweinsteigeri: Mësova shumë nga Zidane

Ish-mesfushori i Bayern Munchenit, Bastian Schweinsteiger, ka kujtuar kohët kur luante për skuadrën gjermane në Ligën e Kampionëve. Ai ka kujtuar përplasjet me Real Madridin dhe Zinedine Zidanen. "E mbaj mend herën e parë, në vitin 2003, në 'Bernabeu'. Jam aktivizuar në pjesën e dytë dhe kam luajtur kundër Zidanes, i cili shënoi një gol të bukur pesë minuta më vonë dhe Real Madridi fitoi 1-0. Të luajturit kundër Zidanes më ndihmoi shumë më vonë, sepse pashë se si ai zhvendosej dhe e mbronte topin. Ishte e pamundur ta imitoje, por mësova shumë nga ato gjëra", ka thënë Schweinsteigeri.

Juve i shtohet garës për De Ligt

Juventusi kërkon ta sfidojë Barcelonën në garë për mbrojtësin e Ajaxit, Matthijs De Ligt. "Bardhezinjtë" duket se janë në avantazh ndaj katalanasve për shkak të marrëdhënieve të mira që kanë me agjentin e lojtarit Mino Raiola. Gjithashtu, sipas raportimeve të medieve italiane, presidenti i Juves, Andrea Agnelli, ka zhvilluar një takim me drejtorin e përgjithshëm të Ajaxit, Edwin Van der Sar, ku kanë folur rreth transferimit të mbrojtësit në Torino. Përveç Juventusit dhe Barcelonës, Matthijs De Ligt ndiqet edhe nga anglezët e Manchester Cityt.

Barça synon transferimin e Iscos

Barcelona po përgatitet për transferimin e Iscos nga Real Madridi në afatin kalimtar të verës. Historikisht që të dyja klubet kanë transferuar nga njëra-tjetra, por që në vitet e fundit raportet e tyre janë më të acaruar. Dy rivalët e La Ligës mund të arrijnë një marrëveshje për Iscon, por që duhet paguar shuma mbi 100 milionë euro për shërbimet e lojtarit.

Rooney: Ende mund të luaj në Premierë Ligë

Sulmuesi i DC Unitedit, Wayne Rooney, beson se ai është ende mjaftueshëm i mirë për të luajtur në Premierë Ligë, që konsiderohet nga shumë njerëz si liga më e vështirë në botë. Golashënuesi më i mirë në historinë e Manchester Unitedit dhe Kombëtares së Anglisë u largua nga Evertoni në qershor dhe nënshkroi kontratë trevjeçare e gjysmë me klubin amerikan. "Nëse tregohem i sinqertë, unë e di se sa i përket aftësisë, unë ende mund të luaj në Premierë Ligë. E di këtë gjë. Gjithmonë kam qenë një njeri me shumë vetëbesim dhe kam pritje të mëdha për veten. Unë u transferova këtu duke pritur nga vetja paraqitje të mirë dhe mendoj se ishte një surprizë për njerëzit që i shprehnin mendimet e tyre për mua, gjë të cilën kanë të drejtë ta bëjnë, por unë kurrë nuk i dyshova aftësitë e mia", ka thënë Rooney.

Zbulohen detajet se si ndodhi tragjedia e Emiliano Sala

Janë publikuar detajet e reja në lidhje me zhdukjen e avionit me të cilin po udhëtonte sulmuesi argjentinas Emiliano Sala. Të dielën e 3 shkurtit ekipi kërkimor arriti t'i gjente rrënojat e avionit në fundin e Kanalit të La Manshit, teksa në bord ishin vetëm futbollisti dhe piloti. Ende nuk është zbuluar shkaku i vërtetë i rrëzimit të avionit, ndërkohë që një intervistë për "L'Equipe", eksperti i aeronautikës, i trajnuar për kërkim-shpëtim, tregon se Sala dhe piloti nuk kishin shanse të shpëtonin, pasi avioni u përplas me 150 km/h. "Nuk kishin shans të shpëtonin, sepse avioni u përplas në sipërfaqen e detit me 150 km/h. Përplasja ishte e dhunshme sepse ne gjetëm jastëkë që lundronim shumë larg nga rrënojat e avionit. Dhe kur gjejmë elemente të brendshme, është provë se përplasja ishte e fortë. Për mua, deri në momentin e fillimit të hulumtimit, nuk kishte asnjë shans për ta gjetur të gjallë pilotin dhe pasagjerin e tij", u shpreh Xavier Tytelman.



Autor: GAZMEND MORINA

STADIUMI MË I MADH NË BRAZIL
SHUMË I MADH, GOXHA (krah.)
ZENDEN EDUARDS
DIJETAR FETAR MYSLIMAN
THAHEM
ZANORE
EPOKA E RE
GJERMANI I VJETËR
KULTURË BUJQËSORE E ARAVE (shq.)
FEMËR LUFTËTARE QË NUK MARTOHEJ NË MITOLOGJINË GREKE (sh.shq.)
TRIER, AUGSBURG

LËNGU I TRASHË QË NXIRRET NGA KULLIMI I NAFTËS
KRYEMURG / DY BASHKË-TINGËLLORE

KËNGËTARE E RE ANGLEZE
TËRËSIA E KUSHTEVE METEOROL-OGJIKE / NDËRIMI; RESPEKTI (arab.)

RADIUM
SKUQJA E LËKURËS NGA ZGJERIMI I KAPILARËVE / MAL I MADH NË TURQI
LËNDË MJEKUESE QË HAP OREKSIN

FJALË E RËNDË, E PAHIJSHME
AJKA E QUMËSHTIT / DEM

QERAMIKA (bised.)
ONTARIO, PENSILVANIA / ZANORE

FILM I YNI "... ISHIN KATËR"
FLETË KU SHKRUHET NJOFTIMI PËR NJË SHFAQJE
BIMË E VENDEVE TË NXEHTA / BOJAXHIU

BASHKËTING.
ISH FUTBOLLISTI FAVZI .... / FEMËR E SAPOMART-UAR
ISLANDA / PËREMËR VETOR
ABEDIN REXHA / MODELJA SHQIPTARE FEJZULLAHU

EPOKA E RE
KËNGËTARI AMERIKAN NË FOTO (origj.)
KLUB FUTBOLLI ANGLEZ
VARG GJËRASH TË NJËJTA (shq.)
INTENSITET, NEON, TON
BASHKËTING.
NJË PREJ FIGURAVE STILISTIKE / FLUTURUESI I PARË SIPAS MITOLOGJISË
KALI I STËRVITUR / ARSIM, SHKOLLIM

BINDJA E FORTË SE DIÇKA ËSHTË E VËRTETË
QË SHEH VETËM DOBINË E MOMENTIT / ZANORE
BASHKËTING. / FJALË QË KA KUPTIM TË NJËJTË ME NJË FJALË TJETËR

AKTORI HOLLIVUDIAN WILSON (shqip.)
PRODUKT QUMËSHTI / TATIMI
SHKODRA, ELBASANI / ZBUKUROJ, HIJESHOJ
KLUB FUTBOLLI GREK (shq.) / INDIUM

LLOJ REVOLEJE ITALIANE
KUNDËRSH-TARI I BOLSHEVIZMIT RUS / MUZIKANTI AMERIKAN SWEETS
TRAJNERI ANGLEZ .... BRUS (Sunderland) / KËNGËTARJA AMERIKANE .... ROSS

PJESË E HAPUR NË MURIN E NJË NDËRTESE
TOTENHAM / SHKRONJA TË NJËJTA
BANOR VENDËS I INDISË / ISH PORTIERI GJERMAN OLIVER
RRYMË E LËVIZJE FETARE E POLITIKE ME RITE MISTIKE

KËNGËTAR I NJOHUR AMERIKAN / LLOJ PAPAGALLI
DY BASHKË-TINGËLLORE
INVA MULA / VENA E GJAKUT
OLIVIER MARTINEZ / LLOJ KROKODILI (shq.)

PJESË E ARMËS NË TRAJTË GYPI (Shq.) / "LOKEREN"
AGIM SELIMI / QYTET NË SHQIPËRI
SHTET NË EVROPË / KOREA BASEBALL ORGANIZATION
TENISTJA KURNIKOVA

LLOJ HELMI LUFTË
NJERI (turq.) / SHTETI MË I POPULLUAR NË BOTË
LLOJ DRURI / STERJO SPASSE

NEVADA
RIFAT AVDIU / ELEKTRODA E POLIT NEGATIV
LLOJ SPORTI / BIMË SHUM-ËVJEÇARE ME TRUNG TË TRASHË
KOHË KUR NIS TË ZBARDHË DITA (sh.shq.)
FUTBOLLISTI AMBROSINI (MILAN) / I VËNGËR, SYSHTREMBËR (Shq.)

EPOKA E RE
VARG NJERËZISH NË VIJË TË DREJTË (shq.) / SKLLAV I LIRUAR
TITULL OTOMAN / ZANORE
SENEGALI, GUINEA / QYTET UNIVERSITAR NË ANGLI
BASHKËTING. / KËNGËTARJA GJERMANE SARAH ..... (shqip.)

PARADHËNIE
YLL FILMI
SHTET NË AFRIKË / LLOJE, SOJE
ALZHEIMER KNOWLEDGE EXCHANGE / STREHIM POLITIK

TRAJNERI KROAT ... BARIÇ
MJESHTËR / ZANORE
IMITUES / VEGËL MUZIKORE

LODËR (shq.)
TITAN / "KENIA"
AKTORJA E FAMSHME TURMAN / ISMET MUNISHI
GAZ PËR PASTRIMIN E PLAGËVE (shq.)

TEATËR NË PRISHTINË
KOMANDANI I NJË ANIJEJE / BASHKËTING.
AKTORI HOLLIVUDIAN ROBERT DE / MOLDE
ZANORE

NATRIUM
RENOVIM
VEGËL MUZIKORE E PËRDORUR QË NË KOHË TË LASHTA

ZGJIDHJA E FJALËKRYQIT: MAZUTI, ABAT, ADELE, KLIMA, RA, ERITEMA, ALAMET, MAZA, KERAMIKA, OP, ATA, BANANE, N, RAMA, I, AR, ANAFORA, ATI, BESIMI, UTILITAR, T, OVEN, KOS, SHE, ARISI, BERETA, ESERI, STIV, DRITARE, T, INDIAN, TYTA, KID ROK, IM, OM, LO, AS, IRLANDA, ANA, ANTRAKS, INSAN, LIS, N, RA, BOKS, MASIMO, KORDONI, AGA, SG, N, KAPAR, NIGERI, AKE, OTO, USTA, IMITATOR, LOJA, TI, UMA, OZONI, ODA, KAPITEN, NIRO, NA, MEREMETIM, LIRA.

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 10, të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpall

K O N K U R S

Për zgjedhjen e 2 (dy) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nga radhët e komuniteteve tjera jo shumicë

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (Këshilli) është organ i pavarur që i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe i cili vendos për ankesat e nëpunësve, si dhe siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil.

Përbërja e Këshillit

Këshilli përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve që zgjedhën nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.
Prej tyre, së paku dy (2) anëtar zgjedhën nga komunitetet joshqiptare dhe së paku dy (2) anëtar duhet të jenë të gjinisë femërore.

Funksionet e Këshillit :

- Mbikëqyr zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil;
- Shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil;
- Mbikëqyrë procedurën e përzgjedhjes dhe vendos nëse emërimet e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, janë zhvilluar në pajtim me rregullat dhe parimet e legjislacionit për shërbimin civil;
- Monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civilë.

Kandidati që aplikon për tu zgjedhur anëtar i Këshillit duhet të ketë kualifikimet dhe të plotësojë kriteret në vijim:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë diplomë të fakultetit juridik të vlefshme sipas ligjit në fuqi;
- Të ketë së paku dhjetë (10) vite përvojë pune profesionale, prej të cilave së paku pesë (5) vite përvojë pune në shërbimin civil;
- Të ketë të kryer provimin e jurisprudencës;
- Të jetë njohës mirë i legjislacionit në fuqi;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil me vendim përfundimtar.

Mandati i anëtarëve të Këshillit

- Anëtarët e Këshillit zgjedhën për mandat shtatë (7) vjeçar, pa mundësi të rizgjedhjes për mandat tjetër.
- Anëtari i Këshillit nuk ka të drejtë që gjatë mandatit të tij të ushtrojë ndonjë funksion tjetër shtetëror, të jetë anëtar i partisë politike apo të marr pjesë në aktivitete politike.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente përcjellëse:

- Dëshmia për përgatitjen shkollore dhe profesionale;
- Letra motivuese;
- Curriculum Vitae (CV - autobiografia);
- Dëshmia se është shtetas i Republikës së Kosovës;
- Dëshmia për përvojën e punës;
- Dëshmia se nuk është i dënuar për vepër penale.

PROCEDURA E KONKURIMIT

Aplikacionet duhet të dërgohen jo më vonë se deri më **26.02. 2019, në orën 16:00.**
Aplikacionet dërgohen personalisht ose me postë në adresën:
Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë (Rr. "Nëna Terezë" pa nr., Drejtoria e Personelit, Zyra N-217);
Aplikacionet mund të merren në këto vende:
Forma e shtypur: në recepcionin e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, rr. "Nëna Terezë" pa nr. ose
Forma elektronike: faqja e internetit e Kuvendit të Republikës së Kosovës – *www.assembly-kosova.org*
Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: (0) 38 211-182, 211-181 dhe (0) 44 567 - 041.
Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e kërkuara.
Përdorimi i aplikacionit të gabueshëm dhe të pakompletuar me të dhënat e kërkuara dhe me të dhëna të paraqitura me vonesë, konsiderohet i pavlefshëm.

Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Skupština Republike Kosova, na osnovu člana 10, Zakona br. 06/L-048 o Nezavisnom nadzornom odboru civilne službe Kosova raspisuje

K O N K U R S

Za izbor 2 (dva) člana Nezavisnog nadzornog odbora za Civilnu službu Kosova, iz redova drugih ne većinskih zajednica

Nezavisni nadzorni odbor za civilnu službu Kosova (Odbor) je nezavisni organ, koji izveštava Skupštini Republike Kosova, rešava žalbe zaposlenih i obezbeđuje poštovanje pravila i načela koja regulišu civilnu službu.

Sastav Odbora

Odbor se sastoji od (7) članova, koje bira Skupština Republike Kosova.
Od toga,najmanje (2) člana biraju se iz ne albanskih zajednica i najmanje (2) člana treba da budu ženskog pola.

Funkcije Odbora:

- Nadgleda primenu pravila i načela zakonodavstva o civilnoj službi.
- Razmatra i rešava žalbe civilnih službenika i kandidata za prijem u civilnu službu.
- Nadgleda proceduru izbora i odlučuje da li su imenovanja civilnih službenika visokog upravnog nivoa i upravnog nivoa,odvijane u skladu sa pravilima i načelima zakonodavstva o civilnoj službi;
- Nadgleda institucije javne administracije, koje su zaposlile civilne službenike u vezi sprovođenja pravila i načela zakonodavstva o civilnoj službi;

Kandidati koji apliciraju za izbor člana Odbora, mora da budu kvalifikovani i da ispunjavaju sledeće kriterijume:

- Da je državljanin Republike Kosova,
- Da je diplomirani pravnik, prema važećem zakonodavstvu, koje je na snazi;
- Da poseduje najmanje 10 (deset) godina stručnog radnog iskustva, od kojih najmanje 5 (pet) godina rada u civilnoj službi,
- Da je završio pravosudni ispit;
- Da je dobar poznavalac važećeg zakonodavstva,
- Da nije kažnjavan pravosnažnom odlukom za počinjeno namerno krivično delo;
- Da prema njemu nije konačnom odlukom preduzeta disciplinska mera udaljavanja iz civilne službe.

Mandat članova Odbora

- Članovi odbora se imenuju za sedmogodišnji (7) mandat, bez mogućnosti ponovnog izbora za još jedan mandat,
- Član odbora nema pravo da u toku svog mandata obavlja drugu državnu funkciju,da bude član političke partije ili da učestvuje u političkim aktivnostima.

Uz aplikaciju moraju se priložiti sledeća propratna dokumenta

- Dokaz o školskoj i profesionalnoj spremi,
- Motivaciono pismo,
- CurriculumVitae (CV-autobiografija),
- Dokaz da je državljanin Republike Kosova.
- Dokaz o radnom iskustvu,
- Dokaz da nije kažnjavan za krivično delo.

PROCEDURA KONKURISANJA

Aplikacije se dostavljaju najkasnije do **26. 02. 2019**. godine, u 16:00 časova.
Aplikacije se dostavljaju lično ili poštom, na adresu:
Skupština Republike Kosova, (ul. „Majke Tereze" bb, Direkcija osoblja, kancelarija br. N-217).

Aplikacije se mogu preuzeti:

Štampani obrazac: na recepciji zgrade Skupštine Republike Kosova, Priština, ul. „Majke Tereze" bb, ili
Elektronski obrazac: web-stranica Skupštine Republike Kosova – www.assembly-kosova.org
Ostale dopunske informacije mogu se dobiti svakog radnog dana *do 16:00* časova, na tel.br. 038- 211-182, 211 – 181 ili (0) 44 567 041.
Aplikacija treba da se dostavlja uz tražena dokumenta.
Korišćenje pogrešno popunjene i nekompletne aplikacije sa potrebnim podacima dostavljene sa zakašnjenjem, smatraće se nevažećim..

Në 32 vjetorin e ndarjes nga jeta,
e kujtojmë djalin dhe vëllain tonë

Gëzim Sahit Salihu

(6 janar 1974 - 6 shkurt 1997)

Na ike befasisht, por gjithmonë je në zemrat tona.
E Kujtojnë: Prindërit : Sahiti dhe Refiqja; motrat: Teuta, Ardiana, Albana, Arjeta, dhe Vlora me fëmijët dhe familjet e tyre nga Ferizaj.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Beni 1" Sh.p.k Cërnillë, Ferizaj, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për projektin teknologjik të impianitit (seperacionit) në Cernillë komuna e Ferizajt.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 07.03. 2019 në ora 11:00 në hapësirat e restorant të stacionit të derivateve "Eida Petrol" në fshatin Prelez i Muhaxhereve komuna e Ferizajt do të organizohet debat publik nga kompania "Beni 1" Sh.p.k Cërnillë, Ferizaj, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për projektin teknologjik të impianitit (seperacionit) në Cernillë komuna e Ferizajt.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "A-Z Group" Sh.p.k Rezallë, Skenderaj, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për eksploatimin e gëlqerorëve të mermerizuar në Bukovik-Syriganë komuna e Skenderajt.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 08.03. 2019 në ora 11:00 në hapësirat e restorant "Pemishta" në qendër të bashkësisë lokale në Runik komuna e Skenderajt do të organizohet debat publik nga kompania "A-Z Group" Sh.p.k Rezallë, Skenderaj, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për eksploatimin e gëlqerorëve të mermerizuar në Bukovik-Syriganë komuna e Skenderajt.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

ODA EKONOMIKE E KOSOVËS | KOSOVA CHAMBER OF COMMERCE

Adresa: Nëna Terezë, Nr:20, 10000 Prishtinë - KOSOVË
Tel: +381 (0) 38 224 741, Tel&Fax: +381 (0) 38 224 299
info@oek-kcc.org, www.oek-kcc.org

ODA EKONOMIKE - KOSOVA CHAMBER E KOSOVËS OF COMMERCE
NO: 43
04.02.2019
PRISHTINË

Prishtinë,më: 07.02.2019

ODA EKONOMIKE E KOSOVËS, SHPALLË

K O N K U R S

Për plotësimin e këtyre vendve të punës në OEK:

Pozita: **Një (1) Drejtor për Njësinë Rajonale të Prizrenit**
Pozita: **Një (1) Zyrtar/e për administratë – Prishtinë**

Kohëzgjatja e kontratës: **Me një periudhë provuese prej 1 viti (me mundësi vazhdimi)**

Shkathtësitë, aftësitë dhe karakteristikat tjera:

- Të ofrojë dëshmi të punës profesionale, Gatishmëri për punë ekipore, në stres dhe orar fleksibil,
- Të punojë i pavarur në përmbushjen e detyrave të dhëna.

Kualifikimet që kërkohen:

- Të ketë të kryer së paku Fakultetin (katërvjeçar) apo master.
- Njohuri të punës me kompjuter, e domosdoshme,
- Kualifikimet plotësuese profesionale, kanë përparësi.

Kandidatët e interesuar mund të dërgojnë CV në email adresën: Fatmire.shala@oek-kcc.org, deri më datën 21.02.2019.

Kandidatët e seleksionuar do të kontaktohen për intervistë.

EUROCHAMBRES | A member of ICC WORLD CHAMBERS FEDERATION | IRU International Road Transport Union | ISO 9001:2008

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Bajram Kelmendi shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Ahmet Delija" Skenderaj.

▶ Sabit Salihu shpall te pavlefshme dëftesat e vitit 1,2,3 dhe diplomën e shkollës se mesme SH.M.L "Dardania" Hani Elezit.

Mirsade Veliu shpallë të pavlefshme INDEX-in, e Fakultetit Juridik të UP-së, Prishtinë me nr. 650/2002.

▶ Besnik Ramaj shpallë të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Arkitekt Sinani" të shkollës Teknike Mitrovicë.

▶ Agron Kriezi shpalle te pavlefshëm dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme "Ymer Prizreni" - Prizren.

▶ Verim Badalli shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Dëshmorët e Zhurit" Zhur.

▶ Mert Flugini shpall te pavlefshme dëftesat e vitit X, XI, XII shmlt "11 Marsi" Prizren.

▶ Bahtija PEZA shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI- IX shf "Motrat Qiriazi" Prizren.

▶ Vebi Hashani shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi52 000€. Për info 044/672-439.

▶ Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irno 044/672-439.

▶ Shes banesën hyrja e 7 mbi kurriz te banesat e gjelbërta përball shkollës "Xhemajl Mustafa" e rinovuar tërësisht. Banesa ka 82 metra katror. 3 dhoma, sallon, shpajz dhe ballkon + taras me shfrytëzim. Çmimi 75000 Euro me para te gatshme, por bej edhe ndërrim me banesë me të vogël në Prishtinë ose banesë më të madhe në Fushë Kosovë sipas marrëveshjes. Numri kontaktues: 044 672 439

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100% mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues

ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L